

**SHPËTIMI
NGA
PASURIA
HARAM
kamata**



**EURO 2008 DHE MUSLIMANËT • PARA SE TË KËRCËNOHEMI...
RAUNDI I FUNDIT I SHEKULLARËVE NË TURQI
MOTIVET • NËNA DHE BASHKËSHORTJA
LUFTIMI I TË KËQIJAVE**

1 KORRIK 2008 27 Xhumad el Ahir 1429 Viti VI nr.60

MK 50 DEN KV 0.80 €
AL 100 LEK
ISSN 1409-6250



**Lehtë për ta gjetur
Vëshirë për ta haruar**

Flugger Decor

F.A.G KOM Shkup
Rr.Xhon Kenedi 9a lok. 14
tel:+389(2)2600154
fax:+389(2)2601248
Rr. Sava Kovacevic nr.2
tel:+389(2)2779220
e-mail: fag-kom@hotmail.com
www.flugger.com.mk





alb
ISLAM

**Hapësirë
për
reklamën
tuaj**

**Hapësirë
për
reklamën
tuaj**



alb
ISLAM



TË JESH MIRËNJOHËS

Vetëm mendjemadhi shtiret se nuk ka nevojë për ndihmën e askujt dhe kësisoj të gjitha të mirat ia përshkruan vetvetes dhe për të këqijat fajëson të gjithë ata që ka pranë. Ndërsa ai që zotëron edhe tiparet më të vogla njerëzore, të mos flasim për tiparet e një besimtari të denjë, për çdo sukses që arrin dhe për çdo të mirë që përjeton, të cilat mbase i ka fituar pas një mundi të madh personal, ky njeri mundohet të shprehë mirënjohjen dhe falënderimin ndaj atij që e ka ndihmuar. Iu drejtohet ndihmëtarëve me falënderim dhe Ndihmëtarit të vërtetë në veçanti. Myslimani është i bindur se Allahu është Ai që ia jep përkrahjen robërve të Vet në çdo punë të mbarë, Ai jep ndihmën e Tij aq sa kanë merituar, por shpeshherë jep edhe më shumë se kanë merituar. Jep më shumë, sepse mëshira e Tij ka tejkaluar zemërimin e Tij dhe se punët e mbara ka marrë përsipër t'i ndihmojë. Ai ka thënë: **“Gjithsesi, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë”.**

Mirënjohja dhe falënderimi çdoherë mbetet cilësi e theksuar e besimtarit dhe këtu s'kemi pse të habitemi kur kemi parasysh se gjatë natës dhe ditës, me dhjetëra herë lexojmë: “elhamdu lilahi rabbil alemin – Falënderimi dhe lavdërimi i takon Allahut” dhe kësisoj mësohet shpirti ynë që të shprehi mirënjohjen ndaj secilit që na jep edhe përkrahjen më të vogël.

Prandaj, nëse dëgjojmë se një besimtar thotë: “Kush ma mëson një shkronjë jam i gatshëm të bëhem rob i tij” nuk habitemi, sepse besimtarët njohin madhësinë e dijes dhe kuptojnë rëndësinë e të qenit besimtar i mirë. Prandaj ai që bëhet shkak që e mira të jetë e qartë, duhet falënderuar dhe respektuar. Në revistën tonë, një gjë të tillë e kanë mundësuar dhe po e mundësojnë shkrimet dhe punimet e hoxhallarëve, që ju të nderuar lexues i lexoni në çdo numër të revistës. Allahu i shpërbleftë dhe ua shtoftë dijen, mirësinë dhe singëritetin.

Ju më pak, falënderimin dhe mirënjohjen tonë e meritoni edhe ju lexues të nderuar, të cilët – pas Allahut – e ndihmoni këtë revistë në mënyra të ndryshme, duke filluar nga leximi i punimeve e deri te abonimet dhe donacionet e sinqerta. Madje, çdo ndryshim që vëreni nga ky numër është bërë edhe me ndihmën tuaj, të cilët me anë të plotësisimit të pyetësorit që ua kemi dërguar, na treguat sa kishim punuar dhe si duhet punuar edhe më mirë. Shpresojmë që kjo lidhje të bëhet edhe më e fortë në të ardhmen, sepse duhet të bëhemi edhe më të mirë, apo jo?

Ah, mos të harrojmë të shprehim mirënjohjen edhe ndaj MPB të RM-s, të cilët na bastisën zyrat dhe deshën të na pengojnë nga puna, por na duhet të themi se kjo na e shtoi edhe më shumë vullnetin për të punuar. Pasi jam mirënjohës do të lutem singërisht që edhe atyre t'u shfaqet e vërteta, si e vërtetë me qëllim që ta pasojnë dhe e pavërteta t'u shfaqet si e tillë, me qëllim që sa më lehtë ta braktisin atë.

Ju urojmë lexim të këndshëm në revistën tuaj dhe tonën njëkohësisht dhe ju porosis që motoja jonë për mirënjohjen le të jenë fjalët e Muhamedit, paqja e lavdërimi qofshin mbi të: **“Shfaqja e dhuntive të Allahut është mirënjohje dhe fshehja e tyre është mohim. Ai që nuk falënderon për pak, nuk di të falënderojë as për shumë. Ai që nuk falënderon njerëzit, nuk di të falënderojë as Allahun. Bashkimi është bereqet ndërsa ndarja është dënim”.** ■

në emër të redaksisë: Omer Berisha

AKTUALE

Përballja me misionarizmin e krishterë **3-7**
Raundi i fundit i shekullarëve në Turqi **8-12**
Amerika: Rebele ndaj demokracisë **13-14**

AKIDE

Sqarime rreth rregullit: Kush nuk i thotë qafirit qafir, ai është qafir **15-18**

KËNDI IM

Euro 2008 dhe muslimanët **19-21**
Planifikimi strategjik **22-24**
Sharjet më të rënda **25-28**

FIKH

Shpëtimi nga pasuria haram, siç është kamata **29-32**

AVANCIMI PERSONAL

Forca lëvizëse e sjelljes së njeriut **33-35**

FAMILJA

Përpara se t'i drejtohesh kërcënimit **36-38**

Suretu Nisa - privilegj për femrën **39-41**
Nëna dhe bashkëshortja **42-43**

TEFSIR

Kërkimi i udhëzimit me Kuran **44-46**

HADITH

Luftimi i të këqijave **47-50**

LIBRI

Integrimi i fesë dhe identitetit mes muslimanëve të ballkanit **51-52**

BOTA ISLAME

Bota Islame **53-54**

FETVA DHE KONSULTIME

Ndërtimi i xhamive **55-57**

HISTORI

Besimtare që s'i harroi historia **58-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.
Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA
Roald HYSA – redaktor gjuhësor
Halil BERISHA – redaktor teknik
Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 1400

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com

NUN-R DOOEL
Xhirollogaria: 30000001759616
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (denar)
Xhirollogaria: 0270100209184
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (euro)
rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4
S.W.I.F.T. : KOBSMK2X

IBAN MK07300701002091869
Numri tatimor: 4030003487017

PËRBALLJA ME MISIONARIZMIN E KRISHTERË

KRISHTERIZIMI I MUSLIMANËVE, QËLLIMET DHE RRUGËT E TIJ

SHKRUAN: BLENDAR HAXHIU

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi vulën e profetëve, Muhamedin, familjen e tij të nderuar, shokët e tij besnikë dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Çdokush që ndjek nga afër reformat dhe hapat që janë ndërmarrë kohëve të fundit ndaj shqiptarëve –ashtu sikurse dhe në të gjithë botën – janë më se të sigurt se ato edhe nëse nuk shfaqen dukshëm, përsëri në sloganet e tyre e ndër veprime të tjera mund të shihet qartë tendenca dhe qëllimi që ato përmbajnë: **“Krishterizimin e muslimanëve shqiptarë”**. Nëse do të numëronim shoqatat e akredituara në Shqipëri gjatë këtyre dy dekadave të fundit, të cilat punojnë për këtë qëllim, pa hezitim mund të thuash se ato e kalojnë limitin e një vendi me më pak se 30 % të krishterë; ato janë mbi 200 shoqata dhe organizata të tilla.

Por këtu del me të drejtë pyetja: Cili është shkaku real i këtyre organizatave dhe strukturave të tyre? Mos vallë qëllimi real i tyre



është që të gjithë muslimanët shqiptarë të kthehen në të krishterë të vërtetë, apo diçka tjetër?!

Nëse do të hedhim një shikim në deklaratat e flamurtarëve të këtij fenomeni, të zbulohet qartë se kush është qëllimi real i një përpjekje të tillë. Është për t'u pranuar pa mëdyshje, se një numër i madh i këtyre organizatave kanë si qëllim të vetin konvertimin e muslimanëve në të krishterë me të gjitha rrugët e mundshme, por një pjesë tjetër krishterizimin e muslimanëve e kupton ndryshe. Në shoqëritë me shumicë muslimane përpjekjet e këtyre organizatave kanë pohuar, se ato me krishterizimin e muslimanëve kanë një qëllim tjetër, me anën e të cilit ata do të mund më pas të realizonin qëllimet e tyre më lehtë.

Dihet nga të gjithë se nuk është e lehtë që një musliman ose një shoqëri e tillë, e cila e njeh si duhet fenë dhe mësimet e saj, të pranojë të konvertohet në krishterizëm, ndaj dhe të krishterët përpjekjet e tyre i kanë fokusuar gjetiu. Ja, se si shprehet një nga të parët e kësaj nisme –Samuel Rajmer: “Ju e keni çuar në vend mesazhin, të cilin jua ngarkuan, arritët suksese të mëdha, edhe pse disa prej jush nuk kanë arritur akoma të kuptojnë qëllimin e duhur. Unë po ju pohoj se ata muslimanë, të cilët kanë hyrë në vathën e Krishterimit, nuk kanë qenë muslimanë të vërtetë, porse ata kanë qenë ashtu sikurse edhe ju e keni pohuar një nga këta tre persona: ose fëmijë të vegjël, prindërit e të cilëve nuk u kanë folur gjë për Islamin; ose njeri që fshihet në hijen e feve dhe që kërkon prej tyre veç kotheren e bukës, në një kohë që e ka pllakosur varfëria; ose dikush, i cili ka dashur të arrijë me anë të fesë qëllimet e

“...nuk është e lehtë që një musliman ose një shoqëri e tillë, e cila e njeh si duhet fenë dhe mësimet e saj, të pranojë të konvertohet në krishterizëm...”

tij personale. Ndërsa qëllimi i misionit për të cilën ju kanë ngarkuar shtetet e krishtera në shoqëritë dhe shtetet muslimane, nuk është e domosdoshme që muslimanët të hyjnë në fenë e krishterë, sepse ky është një udhëzim dhe nder për ta. Por qëllimi juaj i vërtetë është që t'i nxirrni muslimanët nga feja e tyre Islame, në mënyrë që të agojë një krijesë e cila nuk ka asnjë lidhje me Zotin, kështu që vetvetiu ata nuk do të kenë asnjë lidhje me moralet në të cilat mbështeten popujt në jetën e tyre”.¹

Ndërsa kryepeshkopi Shnoda² në një takim me misionarët e krishterë nga dyzet shtete të ndryshme ka thënë: “Është e domosdoshme që të rriten përpjekjet e misionarizmit të krishterë rreth planit misionar, i cili ka si qëllim atë për të cilën kanë rënë dakord të gjithë misionarët për periudhën e ardhshme: Përqendrimi i misionarëve mes grupeve dhe bashkësive duhet të jetë më i fokusuar se puna me individët, kjo për të vetmin fakt që të mund të tronditim besimin e një numri sa më të madh njerëzish në mesin e muslimanëve. A mos mendoni vallë se është e domosdoshme që ata të hyjnë në

¹ Marrë nga libri: “Rrënjët e fatkeqësive”, të autorit Abdullah Tal; Bejrut 1988.

² Shnoda ka qenë kryepeshkopi i kishës ortodokse të Egjiptit.

krishterim? Nëse ju vërtet mendoni një gjë të tillë, atëherë nuk e keni kuptuar thelbin e misionarizmit. Historia dhe përvoja na ka treguar se është e pamundur që një musliman të kthehet e të bëhet një i krishterë i vërtetë. Nëse ne dalim me sukses në zbatimin e këtij plani misionar, atëherë ne do të kemi sukses që t'i largojmë këto grupe nga rruga jonë".³

Megjithatë misionarët e krishterë në përpjekjet dhe në fushatat e tyre, në vendet me shumicë islame dhe jashtë tyre –ku shpenzojnë shuma dhe përpjekje kolosale – kanë edhe qëllime të tjera: ku ne mund të përmendim disa prej tyre:

1. Parandalimi i të krishterëve që të përqafojnë Islamin, normalisht këto përpjekje janë më të mëdha në bashkësitë ku të krishterët janë më të shumtë në numër.

2. Parandalimi i popujve të tjerë të pranojnë Islamin, duke e penguar përhapjen e Islamit në këto popuj dhe duke zëvendësuar me Krishterimin, ose duke stimuluar besimet vendore pagane të trashëguara.

3. Nxjerrja e muslimanëve, ose të një pjese prej tyre nga Islami dhe kjo është nga qëllimet largpamëse, sepse frytet e saj nuk përkohjnë me mundin, të ardhurat dhe efektivat e përdorur për këtë qëllim.

4. Predikimi i Krishterimit dhe shuarja e Islamit në popull, në mënyrë që kolonizimi dhe shfrytëzimi i këtyre popujve të jetë sa më i lehtë dhe më i pranuar nga masat.

5. Hedhja e dyshimeve dhe rritja e paqëndrueshmërisë në masat, të cilat refuzojnë ta lëshojnë Islamin, në mënyrë që ta dobësojnë qëndresën e tyre dhe nga këto metoda janë edhe përpjekjet e njëpasnjëshme të kohëve të fundit për

diskriminimin e Islamit apo të profetit Muhamed, salallahu alejhi ue selem, të cilat vazhdojnë të ndodhin në Perëndim.

6. Sugjerimi se principet dhe metodat e krishtera janë më të mira dhe më të përparuara se principet e tjera, ky është qëllimi kryesor i tyre dhe kërkojnë që të zëvendësojnë principet Islame me ato të krishtera.

Këto janë disa nga qëllimet e të krishterëve në misionin dhe përpjekjen e tyre për t'i nxjerrë muslimanët nga feja e tyre.

Rrugët dhe metodat e misionarëve për të realizuar qëllimet e tyre.

Është po aq e rëndësishme që të përmendim edhe disa nga mënyrat, të cilat i përdorin misionarët e krishterë për të arritur qëllimet e lartpërmendura e të tjera, ku më poshtë do të përmendim disa prej tyre:

Metodat e misionarëve të krishterë ndahen në dy pjesë:

Metoda misionare të qarta. Kjo metodë është dy llojesh:

Metoda misionare shkencore e

“A mos mendoni vallë

se është e domosdoshme që ata të hyjnë në krishterim?

Nëse ju vërtet mendoni një gjë të tillë, atëherë

nuk e keni kuptuar thelbin e misionarizmit...”

³ Shkëputur nga libri: “Atë që muslimanët duhet ta njohin rreth realitetit të misionarëve të krishterë”, i autorit: Ibrahim Sulejman Xhebban. Rijad 1983.

arsimore, duke hedhur dyshime në mesin e shoqërisë Islame në lidhje me fenë e tyre, të përdorura në forma arbitrare.

Metoda misionare e kthimit me dhunë në të krishterë, e cila përmbledhet në kryqëzatat e ndërmarra në vendet Islame dhe kolonizimin e tyre, vende të cilat përjetuan keqtrajtime, vrasje, rrëmbime e bastisje.

Organizatat misionare:

Ndoshta dikush mund të tronditet nga shifrat që mund të jepen këtu, porse ky është një realitet që bëhet dita-ditës më tendencioz, duke e ditur se këto janë statistikat e fundit të shekullit të 20-të. Sot në botë janë afërsisht 250.000 shoqata të krishtera. Ato kanë në juridiksionin e tyre 100.000 qendra, institute dhe stacione për përgatitjen e misionarëve për nivelin e botës islame.

Ekspeditat e jashtme kanë realizuar të ardhura në vlerë prej mbi 8.9 bilionë \$. Kanë shtypur e botuar 8861 tituj dhe 24.900 revista mujore krishterizuese, ndërsa shifra e Ungjillëve të shpërndarë falas kap shifrën e më shumë se 53 milionë kopjeve. Stacionet radiotelevizive të krishtera janë 3240, ndërsa gjatë vitit 1991 për mbështetjen e buxhetit të

“Stacionet radiotelevizive të krishtera janë 3240, ndërsa gjatë vitit 1991 për mbështetjen e buxhetit të krishterizimit janë dhënë afro 181 miliardë \$...”

krishterizimit janë dhënë afro 181 miliardë \$. Kjo tregon qartë shtimin e madh të mbështetjes dhe përkrahjes financiare të krishterizimit në nivel botëror.

Metodat misionare indirekte, të cilat përfaqësohen nga Delegacionet dhe qendrat e ndryshme.

Veç asaj që përmendëm, në këtë drejtim punojnë dhe shërbejnë dhe një sërë delegacionesh e qendrash të fushave të ndryshme, si në:

Mjekësi, ku në pamje të parë ato duken si delegacione humanitare, sepse ndërtojnë spitale dhe qendra shëndetësore, por që nga ana tjetër kryejnë misionin e krishterizimit të vërtetë.

Qendra trajnimi, të cilat synojnë të rinjtë dhe të rejat dhe ku më pas nëpërmjet mësimave dhe leksioneve, përhapin frymën e krishterimit.

Ajo që duhet theksuar këtu është dhe fakti, se shumë nga anëtarët e këtyre qendrave punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin e disa teksteve shkollore, ose në formën e konsulencës, duke bërë kështu të mundur futjen e frymës së krishterë në bankat e shkollave dhe nxënësit e tyre.

Ndihma humanitare, të cilat përfshijnë të gjitha shtresat e shoqërisë, e ku bashkë me pakon e ndihmave do të gjejnë biblën ose broshura për krishterimin.

Delegacione diplomatike, të cilat vijjnë nëpërmjet ambasadave apo konsullatave, të cilat nëpërmjet politikës ushtrojnë shpërndarjen e frymës së krishterimit, dhe kjo duket qartë të paktën në realitetin shqiptar, dhe deklaratat e politikanëve të tyre, të cilët e kanë më të lehtë të pohojnë se janë të krishterë, se të pranojnë realitetin e shumicës Islame. Këto delegacione apo organizata punojnë me

projekte afatgjatë, misionarizmin e të cilave jo çdokush arrin ta kuptojë.

Masmedia, e cila është një nga rrugët më të fuqishme dhe më të shfrytëzuarat nga misionarët e fshehtë të Krishterimit në të gjithë botën, një gjë e tillë duket qartas edhe në mjediset shqiptare, ato fokusohen në emisione të drejtpërdrejta si meshat kishtarë e të ngjashme me këto, dhe indirekte ku misionin e tyre e përcjellin shumë bukur me anë të telenovelave të ndryshme, apo programeve kulturore. Madje ata kujdesen aq shumë në këtë drejtim, saqë mesazhet e tyre janë shumë të qarta edhe në filmat vizatimorë për fëmijë.

Përballja me misionarizmin e krishterë.

Edhe pse këto fenomene janë përhapur shumë, përsëri në përgjithësi ka përpjekje nga muslimanët për t'i bërë ballë kësaj fushate të krishterizimit në rang botëror, ku edhe muslimanët shqiptarë kanë pjesën e tyre të përpjekjeve. Muslimanët në përgjithësi dhe njerëzit e dijes në veçanti duhet që në këtë situatë të ndërgjegjësohen dhe t'i kushtojnë rëndësi asaj me të cilën pa dyshim që do të rregullohet gjendja e njerëzve dhe e vendit; ata duhet të ushtrojnë thirrjen në rrugë të Allahut, sepse Feja Islame është e qartë, pa ndonjë filozofi të pakuptueshme, ajo është fe e natyrshmërisë, ajo është alternativa e vetme, e cila e mbush njeriun nga ana shpirtërore, gjë e cila shpjegon dhe konvertimin e shumë të krishterëve, madje dhe nga vetë misionarët e tyre në Fenë Islame.

Qëllimi i muslimanëve në këtë përpjekje nuk duhet të jetë vetëm në kuptimin e kundërpërgjigjes, por duhet të ketë në thelbin e vet kthimin e njerëzve në fenë e Allahut, me një kthim të vërtetë dhe

“...Feja Islame është e qartë, pa ndonjë filozofi të pakuptueshme, ajo është fe e natyrshmërisë, ajo është alternativa e vetme, e cila e mbush njeriun nga ana shpirtërore...”

t'i nxjerrë ata nga kthetrat dhe lëngatat e degjenerimit, të cilat u janë shërbyer nga bota e krishtere.

Ballafaqimi me këtë realitet është që t'u servirim muslimanëve në trojet shqiptare, atë që u ka munguar dhe që besojmë se është e vërteta, të cilën e ka sjellë Kurani dhe Suneti i profetit Muhamed, salallahu alejhi ue selem. Çdo thirrës duhet të punojë në këtë drejtim duke besuar se kjo është fe që Allahu do ta bëjë të triumfojë e do ta ngrejë më lart ndaj feve të tjera, sepse është e vërteta që Ai ka zgjedhur, ndryshe përse tërë kjo frikë dhe pasiguri nga Islami, në vendet evropiane -të cilat po humbin energji të papara për të kthyer muslimanët në të krishterë-, në veçanti në Francë, që sipas studimeve të fundit thuhet se ajo në vitin 2050 do të bëhet shtet Islam.

“Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobsimtarët. Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Saf, 8-9.) ■

RAUNDI I FUNDIT I SHEKULLARËVE NË TURQI



NEBIL SHEBIB

Cështja e shamisë në Turqi u zgjerua dhe u thellua më shumë se sa të jetë thjesht një çështje kushtetuese, ligjore ose politike.

Raundi i fundit i shekullarëve nuk do të jetë në favor të tyre, pasi pyetja thelbësore nga pikëpamja historike nuk kufizohet në faktin se një vajzë muslimane do të hyjë në universitet me shami ose do të pengohet nga arsimimi, specializimi dhe pjesëmarrja në procesin e zhvillimit, ndërtimit dhe përparimit?

Gjithashtu nuk është pyetje thelbësore se: a do të mbetet partia për zhvillim dhe drejtësi e njëjta apo jo? A do ta zëvendësojë një parti e ngjashme me të, apo do të vazhdojë në rrugën e arritjeve edhe me gjithë hasmëritë e shumta?

Por pyetja thelbësore që na paraqitet është: si do të përcaktohet fundi i shekullarizmit fundamentalist?!

Shihet qartë se ata nuk do të arrijnë të marrin pjesë në raundin e fundit të ballafaqimit, mirëpo dëmi që do t'i shkaktojnë Turqisë në udhëtimin e tyre drejt përparimit dhe zhvillimit dhe realizimin e të drejtave dhe lirive personale do të jetë shumë i madh.

Pranga historike

Në fillim ishte iluminizmi, pastaj modernizmi e pastaj shekullarizmi. Ky është edhe vargu historik nëpërmjet të cilit kaloi Evropa. Kaloi nga errësira e dekadencës ideologjike dhe humane, në ofertat e iluminizmit, kohë në të cilën filloi edhe revolucioni industrial, pastaj nga etapa e iluminizmit kaluan në etapën

“...S’është çudi që goditja e parë i është drejtuar gruas, pasi që gruaja e ndershme, e lirë, e arsimuar, e vetëdijshme dhe prodhuese është hallka e parë për prodhimin e njeriut...”

e modernizmit dhe etapën e “dominimit të mendimit nga shkenca”, kohë kur filozofia fetare kishtare kishte monopolin mbi shkencën dhe mendimin dhe e konsideronin vetveten si burimin e njohjes. Me etapën e modernizmit filloi edhe procesi i largimit të prangave, të cilat kishin zhdukur liritë ideologjike dhe humane. Pas kësaj etape u kalua në etapën e përhapjes së ateizmit dhe materializmit, të cilat e shoqëronin shekullarizmin me zhvillimet e njëpasnjëshme dhe botëkuptimet madhore të kapitalizmit, komunizmit dhe ekzistencializmit. Kështu vazhdoi procesi i shkencës, teknologjisë dhe prodhimit material, mirëpo filloi shembja e vetë njeriut, duke filluar me gjenocidin ndaj indianëve e deri tek ajo që po përjetojmë sot.

Shekullarizmi në disa vende muslimane, sidomos në Turqi dhe Tunizi ka filluar andej nga ka ardhur në Perëndim. I ka vënë vetes titullin e iluminizmit, mirëpo është pa përmbajtje, pretendon për veten modernizmin, mirëpo ka përfunduar epoka historike e

saj.

Kështu shekullarizmi në vendet muslimane, ose së paku në disa prej tyre, nuk i ka kaluar etapat historike që ka kaluar në Evropë, ata që nga fillimi dolën me përmbajtje fundamentaliste puritane, boshti i tyre është detyrimi, rezultati tirania, kurse synimi i tyre ndërtimi i njeriut tjetër, i zhveshur nga bindjet fetare dhe humane, vlerat dhe morali i tij.

S'është çudi që goditja e parë i është drejtuar gruas, pasi që gruaja e ndershme, e lirë, e arsimuar, e vetëdijshme dhe prodhuese është hallka e parë për prodhimin e njeriut, prandaj nëse shekullarizimi ia del ta zhveshi gruan nga këto cilësi, ajo nuk do të mund të prodhojë një njeri fisnik, të lirë, të arsimuar, të vetëdijshëm dhe prodhues.

Për këtë beteja e shekullarëve fundamentalistë në Turqi me njeriun përqendrohet në mbulesën e gruas, ashtu si s'ka ndodhur në asnjë vend tjetër, madje as në Tunizi e as në Francë.

Beteja e brezave dhe ajo që po ndodh në Turqi këto ditë tregon qartë se forcat shekullariste pasi i humbën të gjitha betejat, tani kanë filluar të humbin edhe betejën e hixhabit, e cila ishte beteja parësore në Turqi.

Deficiti shekullarist

Ligjet që ka prodhuar shekullarizmi në fazën e parë kanë qenë të qarta në luftën e tyre kundër njeriut në Turqi, në aspektin gjuhësor, historik, besimor dhe manifestues, duke përfshirë këtu edhe hixhabin. Ata për një kohë të gjatë të rrugëtimit të tyre diktatorial i veshën vetvetes petkun e “demokracisë dhe përparimit”, kurse drejtimet e ndryshme islame që mbetën pas Luftës së Parë Botërore iu veshën përshkrime

“Lëvizja Islame në Turqi ka aftësi të bashkëveprojë me realitetin për të ndërtuar ardhmërinë mbi baza përmbledhëse të të gjitha mejdaneve të jetës...”

“dekadente dhe errësore”. Mirëpo këta njerëz, me sa duket akoma nuk e kanë kuptuar se gjendja në Turqi, po edhe në mbarë botën ka ndryshuar rrënjësisht.

Lëvizja Islame në Turqi ka aftësi të bashkëveprojë me realitetin për të ndërtuar ardhmërinë mbi baza përmbledhëse të të gjitha mejdaneve të jetës, prandaj demokracinë, të cilën shekullarizmi turk e ka boshatisur nga çdo kuptim, lëvizja islame i ka dhënë një përmbajtje të vërtetë dhe përfshirëse të të gjitha shtresave, drejtimeve, partive, besimeve etj. Kurse përparimin si synim strategjik të shtetit, të cilin shekullarët nuk arritën t'i japin kurrfarë domethënie, këta e shndërruan në realitet ekonomik, teknologjik, financiar dhe shkencor në raportet e Turqisë me botën dhe në përditshmërinë e individit në Turqi.

Edhe pse brezi i rinisë është rritur në prehrin e shekullarizmit fundamentalist loja e ushtarakëve, politikës dhe e partive nuk arriti ta çojë atje ku dëshiruan ata, sepse ata u bënë thjesht një brez i vetëdijshëm, e kjo shihet shumë qartë tek vajzat universitare, të cilat këmbëngulën në të drejtën e tyre për shkollim, punë, duke ruajtur fenë, që tashmë nuk paraqet vetëm një problem ligjor dhe kushtetues, por ka marrë edhe dimensione civilizuese

e humane, dhe nxori në shesh shumë qartë boshllëkun e fundamentalizmit shekullarist.

Diktatura e shekullarizmit fundamentalist

Shekullarizmi në Turqi ka ecur në rrugën e diktaturës ushtarake, grushtit të shtetit të drejtpërdrejtë, sikurse ndodhi në kohën e Adnan Menderesit dhe jo të drejtpërdrejtë, sikurse ndodhi me rastin e rrëzimit të Nexhmudin Erbakanit, ku e ambalazhuan këtë diktatori me ligje kushtetuese, të cilat i ka nxjerrë dhe prodhuar aparati i diktaturës shekullare ushtarake. Si rezultat i këtyre hapave ndodhi shpartallimi i partive politike, spastrimi i ushtrisë nga “shpirti dhe pamjet fetare”, diktimi i urdhrave ndaj qeverisë dhe parlamentit, privimi i disa liderëve politikë nga zhvillimi i aktiviteteve politike etj. Fryt i gjithë aktiviteteve të tyre ishte humbja e pozitës dhe e bastioneve të veta, njëri pas tjetrit, brenda Turqisë dhe botërisht, prandaj ata e kanë shumë të vështirë të gjejnë ndonjë përkrahje për hapat që ndërmarrin. Nëse në të kaluarën gjenin ndonjë përkrahje për veprimet e veta, tani institucionet evropiane dhe perëndimore, zyrtare dhe jo-zyrtare i kritikojnë haptazi vendimet e fundit të institucioneve fundamentaliste shekullare në Turqi, të personifikuara në udhëheqësinë ushtarake dhe ata që i kanë emëruar, sikurse janë kokat e qendrave universitare, gjyqin, sidomos gjyqin kushtetues dhe prokurorin publik.

Nëse partitë e kaluara arritën të zbulojnë fytyrën e vërtetë të diktaturës shekullare në Turqi, duke përdorur atë që në Turqi e quajnë “politika e dhelprës”, partia e Taip Erdoganit i arriti këto dy gjëra kryesore:

1- Arritje të mëdha në rrafshin politik dhe jetësor, duke krijuar ndërlidhje mes ndërtimit të vendimit politik dhe realitetit jetësor të popullit, gjë e cila e bëri “vullnetin e popullit” mbrojtje për të dhe për arritjet e tij politike, prandaj beteja u shndërrua nga beteja kundër AKP-së në betejë kundër popullit dhe vullnetit të tij.

2- Zbulim i mjeteve të diktaturës së shekullarizmit fundamentalist, duke filluar nga aparati ushtarak, i cili kohëve të fundit tregon një ngecje, duke kaluar nga rektorët e vendosur në krye të qendrave universitare, duke përfunduar tek institucionet e gjyqësisë, të cilat duhet të jenë mbrojtëset e vullnetit të popullit dhe nuk duhet ta shembin këtë përfaqësim të popullit nëpërmjet aparatit ligjvënës, ekzekutiv apo ushtarak. Mirëpo çështja e mbulesës në universitete tregoi qartë se ata nuk janë për të ruajtur vullnetin e popullit, por vullnetin e fundamentalistëve shekullarë.

Veprimet vetëvrasëse të fundit

Askush nuk i frikësohet më ardhmërisë së rinisë, e sidomos vajzave muslimane në Turqi. Shumëkush nuk i frikësohet më as diskursit politik në të

“...çështja e mbulesës në universitete tregoi qartë se ata nuk janë për të ruajtur vullnetin e popullit, por vullnetin e fundamentalistëve shekullarë...”

cilin ecën AKP-ja për ta zhvilluar Turqinë. Ajo që u arrit brenda dy brezave të kaluar paraqet një ndryshim historik, i cili do të ketë jehonë me gjithë pengesat, ndërkëmbësit dhe procedurat kundërshtuese nuk kanë arritur të pengojnë këtë transformim të madh, trupi i madh i të cilit shihet qartë sidomos nëse bëjmë krahasim mes viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, në kohën e Menderesit dhe asaj që po ndodh sot në kohën e Erdoganit dhe Gylit.

Shumë institucione të shoqërisë civile, në Turqi dhe jashtë Turqisë, të cilët edhe vetë janë shekullarë, kanë reaguuar kundër veprimeve të këtyre fundamentalistëve shekullarë, të cilët janë duke e rrëzuar edhe atë pak autoritet, që i ka mbetur shekullarizmit në Turqi, bazë e të cilës është “liria e njeriut”.

Shekullarët që nuk janë fundamentalistë e shohin më mirë se të tjerët rrezikun e madh që ekziston në sjelljen ekstreme të tyre, sidomos kur ballafaqohen me arritjet e mëdha në realitetin turk, të cilat shihen edhe ndërkombëtarisht dhe ndikojnë në realitetin jetësor të popullit.

Tashmë nuk është e mundur largimi i një partie dhe mbështetjen në një parti tjetër, sikurse ndodhte në kohën e Partisë Refah, nuk është e mundur mbështetja në mbizotërimin e udhëheqësisë ushtarake, sikurse ndodhte para një vargu reformash kushtetuese dhe ligjore dhe nuk është e mundur mbështetja në arsyetime të fabrikuara dhe disa protesta të kufizuara për të paraqitur përfaqësimin e vullnetit të popullit.

Si duket AKP-ja, e cila gjer më tani ka arritur sukses në realizimin e synimeve të veta legjitime dhe ka fituar besimin e votuesve, do të ecë në të njëjtën rrugë edhe në këtë raund, i cili i imponohet. Në

këtë ballafaqim hasmi nuk i jep mundësi Turqisë të zgjedhë mes një partie dhe tjetre, mes një drejtimi dhe tjetri, por e vendos para një zgjedhje shumë të vështirë, mes çlirimit të brendshëm dhe arritjeve të mëdha, mes diktaturës dhe dekadencës, gjë e cila mund të sjelli rrezikun e një kaosi shkatërrues, kurse në Turqi askush përpos atyre shekullarëve ekstremistë nuk do ta kishte pranuar këtë rrezik.

Në mejdan është i vetmuar ky grup, i cili mundohet të kapet pas të vjetrës nga pushteti i trashëguar, për të imponuar vullnetin e vet, i cili sipas tyre del përmbi vullnetin e popullit dhe përmbi arritjet e mëdha, që i ka arritur së bashku me liderët politik të votuar nga populli.

Për këtë hapi që ndërmori Gjykata Kushtetuese kundër ligjit të ri, të cilin e nxori parlamenti për të larguar pengesat jo-kushtetuese dhe jo-humane ndaj muslimaneve me shami dhe privimin e tyre nga e drejta për arsimim, paraqet një procedurë vetëvrasëse. Edhe pse ky veprim ka qenë një hap drejt një lëvizje më të madhe, e ky është mbyllja e partisë, e cila para pak kohësh fitoi shumicën e votës popullore në Turqi, kjo do të paraqesë edhe një hap tjetër vetëvrasës më të rrezikshëm dhe më me ndikim në atë që ka mbetur nën dominimin e ekstremistëve shekullarë. ■

*(autori është analist politik
që jeton dhe vepron në Gjermani)
Përshtati: Bekir Halimi*



AMERIKA: REBELE NDAJ DEMOKRACISË

DR. MUHAMED EL-ALI

Dihet se grekët e vjetër ishin ata që themeluan ideologjinë e demokracisë, në veçanti Platoni në librin e tij “Republika” dhe Aristoteli në librin e tij “Ligjet”. Demokracia greke mbështetet mbi parimin se populli qeveris vetveten nëpërmjet të zgjedhurve në parlament. Kjo lloj demokracie u zbatua në qytetet e vjetra të grekëve, siç janë kryesisht Athina dhe pastaj Sparta. Paskëtaj me mbisundimin e

Perandorisë Romake ndaj qyteteve greke, kjo lloj përvoje u shkatërrua. Më pas në epokën e Rilindjes Evropiane, u ringjall sërish kjo lëvizje nga personalitete të ndryshme, siç ishin: Zhan Zhak Ruso, Hops, Xhon Lok, Monsiko etj. Revolucioni francez në 1789 ishte përvoja e parë demokratike në kohën e re, ndërsa diktaturat evropiane filluan të rrënohen njëra pas tjetrës. U shfaqën vlerat e demokracisë me emërtime të ndryshëm, si: “sistemi shumëpartiak”, “pranimi i tjetrit”, “transparenca”, “ndërrimi i pushtetit”, “liria e votimit” etj.

Kështu që shumë popuj që jetonin nën robëri dhe diktatura të ndryshme filluan të dëshirojnë demokracinë dhe të mirat e saj, sepse ajo ishte anija më e mirë për të shpëtuar.

Por tashmë erdhi shekulli amerikan, që të promovojë para popujve një demokraci të re dhe krejt ndryshe, madje mund të themi se kjo konsiderohet si një rebelim ndaj demokracisë evropiane. Në demokracinë amerikane kanë ndryshuar tiparet e lirisë dhe drejtësisë, liria nuk quhet liri përderisa nuk ka natyrë amerikane dhe drejtësia nuk quhet drejtësi përveç nëse pajtohet me kërkesat amerikane. Madje vetë demokracia nuk njihet si e tillë përveçse me peshoren amerikane. Në këtë demokraci vetëm Amerika ka të drejtë të caktojë peshat për matjen e “legalitetit ndërkombëtar”, madje vetëm demokracia amerikane ka të drejtën e shpikjes së termave dhe detyrimin e tyre ndaj të gjithëve, sikurse janë termat: “shtete rebele”, “shtete me drejtësi” “terrorizmi”, “lufta për ekzistencë” ...

Prej tipareve të demokracisë amerikane është se ajo mohon natyrën e demokracisë së parë, prej natyrës saj ishte parulla “qeverisja e vetvetes me vetveten”, ndërsa tani shohim sesi Amerika refuzon zgjedhjen e një populli, nëse ajo zgjedhje nuk është e pranueshme për Amerikën dhe demokracinë e saj. Këtë e pamë më së miri nga refuzimi që i bëri Amerika zgjedhjes së popullit palestinez, kur ata i dhanë votën “Hamazit”.

Prej tipareve të demokracisë amerikane është se ajo ka arritur të bëhet si mjet për legalizimin e kolonializmit bashkëkohor. Kur Amerika dëshiron të kolonizojë ndonjë vend dhe të përvetësojë të mirat e tij, nuk duhet të bëjë më shumë sesa të helmojë ligjin e atij vendi, duke e cilësuar me diktaturë dhe terrorizëm. Paskëtaj ajo pozicionohet si shpëtuese dhe çlirimtare e

“Njerëzit e popullit tonë, që janë hutuar pas demokracisë amerikane dhe e duartrokasën atë, i këshillojmë të mos shpejtojnë, të mos bien pre’ e parullave...”

atij populli, i cili qenka nën sundimin e një terroristi, ajo tani do t’i sjellë lirinë atij populli dhe do të vendosë demokracinë. Argument për këtë është ajo që ndodhi në Irak.

Demokracia amerikane, e cila mëton të shtrihet në të gjithë rruzullin tokësor, s’ka të bëjë me demokracinë e vjetër greke, as me atë evropiane që lindi gjatë epokës së Rilindjes, madje nuk ka të bëjë as me demokracinë që u praktikua në Amerikë dhe Evropë para dhjetëra dekadash. Ajo është një demokraci e re, e cila ka tiparet dhe veçoritë e saj.

Njerëzit e popullit tonë, që janë hutuar pas demokracisë amerikane dhe e duartrokasën atë, i këshillojmë të mos shpejtojnë, të mos bien pre’ e parullave. Nuk duam të na ndodhë ajo që u ndodhi irakianëve, të cilët u mashtruan pas një grupi irakian të amerikanizuar, të cilët hynë në Irak të hipur mbi tanket amerikane. Ja tani, populli irakian e zbuloi mashtrimin dhe po pyet: Ku është liria dhe demokracia?! Ku është qetësia dhe siguria?! Ku janë premtimet amerikane?!

Pyetje dyshuese këto në gjuhët e irakianëve, prandaj merrni mësim, o të zotët e mendjes! ■

Përktheu: Omer B.

SQARIME RRETH RREGULLIT: KUSH NUK I THOTË QAFIRIT QAFIR, AI ËSHTË QAFIR

SHKRUAN: OMER ZAIMI

Falënderimi i plotë i takon Allahut, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen dhe shokët e tij...

Padyshim që shirku është mëkati më i madh që kryhet ndaj Allahut të Lartësuar, ai është mëkati i vetëm, i cili pronarin e tij e bën të përhershëm në zjarr nëse vdes pa u penduar. Ndërsa mëkatet e tjera të mëdha, kush vdes pa u penduar prej tyre është nën vullnetin e Allahut, nëse dëshiron ia fal e nëse dëshiron e dënon, mirëpo ai nuk mbetet në xhehenem përgjithmonë.

Tekstet e Kuranit dhe të Sunetit që e argumentojnë këtë janë të shumta. Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush** (apo diçka tjetër) **veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.”** Nisa, 48.

Ndërsa Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Kush vdes duke mos i bërë shirk Allahut hyn në Xhenet dhe kush vdes duke i bërë shirk Allahut hyn në zjarr.”** Muslimi.

Dijetarët kanë thënë se kush nuk i konsideron kafirët kafira, qofshin çifutë, të krishterë, apo fe tjera, ai është po ashtu kafir.

Në librin “Keshaful-Kana’ë” të Behutit, thuhet: “Kush nuk i konsideron jomuslimanë ata që kanë çfarëdo feje tjetër përveç Fesë Islame, siç janë të krishterët dhe çifutët; apo dyshon në mohimin e tyre; apo thotë se feja e tyre është e drejtë, ai është qafir (jomusliman), sepse është përgënjeshtues i fjalës së Allahut: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve”.**

Mirëpo gjatë kësaj kohe në trojet tona, kjo është një top-temë dhe shfrytëzohet si mjet për të gjykuar si jomusliman me të pa drejtë, saqë në ndonjërin prej forumeve sheh se si dikush i konsideron si jomuslimanë dijetarët, sepse ata nuk e bëjnë tekfir (d.m.th. nuk e konsiderojnë kafir) udhëheqësin e një shteti. Po ashtu vëren se si disa vëllezër e bëjnë qafir dikë, sepse ai nuk e ka konsideruar qafir filanin. Disa të tjerë i sheh se si vjedhin pasurinë e muslimanëve duke e përligjur atë veprim, se ata qenkan qafirë, e kështu me radhë, fitne të ndryshme me të cilat po sprovohehi në këto ditë.

Diçka tjetër që vërehet qartë është fakti se: Ata që e shfrytëzojnë më shumë dhe e propagandojnë këtë rregull, nuk e sqarojnë atë sa duhet, ndoshta nga pakujdesia e ndoshta me qëllim e lënë këtë çështje të mjegullt, e me këtë ia hapin derën atyre që



s'kanë dituri të bien në gabime të rënda dhe mëkate të mëdha, siç është rasti: Tekfiri i muslimanëve me të pa drejtë. Sepse siç thonë dijetarët: t'i quash një mijë qafirë muslimanë me të pa drejtë është më e lehtë, se sa ta quash një musliman qafir me të pa drejtë. Ky është një gabim i rëndë pedagogjik, sepse muslimanët e rinj nuk mund të edukohen kështu, duke u folur më shumë se ajo që kuptojnë së pari, dhe duke mos ua sqaruar atë që ua themi së dyti. Prandaj vendosa që të bëj një sqarim rreth këtij rregulli, në mënyrë që vëllezërit tanë mos të bien në gabime, duke u argumentuar me këtë rregull, saqë siç e përmenda edhe më sipër: Njëri prej tyre i konsideron si jomuslimanë dijetarët e muslimanëve në njërin prej forumeve. Kur t'i thuash: E pse e konsideron të tillë? Të përgjigjet: Kush nuk i thotë qafirrit qafir, ai është qafir. Apo ndonjë fjalë tjetër shumë të palogjikshme: Ata e bëjnë qafirin musliman. Kështu që ngelesh i habitur dhe i trishtuar: Prej nga vjen i gjithë ky guxim dhe mosrespekt ndaj trashëguesve të pejgamberëve, prej nga vjen ky

argumentim i pabazë dhe prej nga vjen kjo metodologji e hidhur?!...

Mirëpo, ky problem nuk është vetëm i yni, ky është problem botëror, saqë një shkrimtar arab rreth kësaj teme shkruan: “Disa prej tyre e kanë bërë tekfir Shejh Ahmed Jasinin, sepse ai thotë se votimi është i lejuar, pastaj e kanë bërë tekfir njërin prej dijetarëve, sepse ai ka thënë: Shejh Ahmed Jasini është shehid i umetit! E gjitha kjo duke u bazuar në rregullin: Kush nuk i thotë qafirrit qafir, ai është qafir!!!”

Prandaj duke u mbështetur në Allahun themi:

Në asnjë ajet Kurani dhe në asnjë hadith të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, nuk do të gjesh ndonjë tekst me fjalët: “Kush nuk i thotë qafirrit qafir, ai është qafir”.

Ky është një rregull, të cilën dijetarët nëpërmjet ixhtihadit e kanë nxjerr nga tekstet e Kuranit dhe Sunetit. Prandaj siç kanë thënë dijetarët: “Fjalët e dijetarëve argumentohen e nuk janë argumente.” Argumenti këtij rregulli shihet në fjalën e Behutit -Allahu e mëshiroftë-: Kush nuk i

konsideron jomuslimanë ata që kanë çfarëdo feje përveç Fesë Islame, siç janë të krishterët dhe çifutët; apo dyshon në mohimin e tyre; apo thotë se feja e tyre është e drejtë, ai është qafir (jomusliman), sepse është përgënjeshtues i fjalës së Allahut: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve”.**

Pra, argumenti i këtij rregulli është nxjerrë nga fjala e Allahut: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve.”**

Mënyra e argumentimit: Allahu i Madhëruar në librin e tij e ka bërë të qartë se çdo pasues i diçkaje tjetër pos Islamit është jobesimtar, se fetë e tjera pos Islamit janë të kota, prandaj kush thotë se ata janë muslimanë, apo se fetë e tyre janë të drejta, ai bëhet kafir. Përse? Sepse e ka përgënjeshtuar fjalën e Allahut! Pra, kjo është mënyra e argumentimit prej të cilit është nxjerr ky rregull. Kjo që thamë të ndihmon shumë për ta kuptuar mirë këtë rregull prandaj analizoje mirë! Madje ky është qëllimi i Shejh Muhamed Ibën Abduluehabit në librin e tij “Të kundërtat e Islamit”: “Kush nuk i konsideron qafira idhujtarët, apo dyshon në kufirin e tyre, apo thotë se feja e tyre është e drejtë, ai është kafir.” E nuk ka si qëllim atë që ka mospajtim rreth kufirit të tij, prej atyre që thonë se janë musliman.

Ndërsa mospajtimi rreth kufirit të atij që thotë se jam musliman, mirëpo ka rënë në ndonjë vepër që të nxjerr nga islami është dy llojesh:

Lloji i parë: Mospajtimi rreth veprës në të cilën ka rënë individi, se a është kufër apo jo? Siç është mospajtimi i imamëve: Ebu Hanifes, Malikut dhe Shafiut me Imam

Ahmedin rreth lënësit të namazit. Ku të tre të parët thonë se nuk bën kufër, ndërsa Imam Ahmedi thotë se bën kufër. Mirëpo Imam Ahmedi nuk u tha atyre: ju jeni qafira, sepse nuk e keni bërë qafirin qafir.

Lloji i dytë: Mospajtimi rreth ndonjë personi të caktuar, edhe nëse pajtohen se vepra në të cilën ka rënë është kufër. Siç është mospajtimi në mes selefit rreth tekfirit të Haxhaxhit, ku shumica nuk e bëjnë tekfir, ndërsa Shabiu dhe Tausi e bëjnë tekfir.

Vërejtje: Mos të mendojë dikush se Shabiu dhe Tausi e kanë bërë tekfir për shkak të zullumit të tij ndaj muslimanëve. Assesi, po për shkak të disa fjalëve dhe veprave të tij, që të nxjerrin nga Islami, si p.sh:

- Thënia e tij, se Sulejmani alejhi selam, ka qenë ziliqar.

- Thënia e tij: “Nëse do t’i urdhëroja muslimanët të dalin nga kjo derë e xhamisë, e ata dalin nga një derë tjetër, mua do të më lejohej pasuria dhe gjaku i tyre.”

- Thënia e tij për Abdullah b. Mesudin se është “koka e munafikëve”.¹

Në thënien e parë ka përçmim për njërin nga pejgamberët e Allahut, ndërsa në të dytën ka lejim të asaj që Allahu e ka ndaluar, kurse në të tretën tallje dhe përçmim për një prej sahabëve më të ditur dhe më të afërt të Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem. Këtu dëshiroj të ndalemi pak dhe të analizojmë rreth gjendjes së selefit dhe rreth hallit tonë:

- Edhe pse Haxhaxhi i kishte thënë ato që përmendëm shumica dërmuese e tyre nuk e bënë qafir, sepse kishte pengesa dhe sepse kishin kujdes nga tekfiri.

- Edhe pse Shabiu dhe Tausi e bënë tekfir, ata nuk thanë se ata që nuk e bëjnë

¹ Libri el-Bidaje uen-Nihaje i Ibën Kethirit v 9, 135

qafir janë qafira gjithashtu, duke u argumentuar me rregullin për të cilin po flasim, siç argumentohen disa që as gjuhën arabe nuk e dinë. Përkundrazi Tausi me shumë edukatë dhe butësi tha: “çuditë me vëllezërit tanë nga Iraku, se si e konsiderojnë Haxhaxhin musliman.” Ai nuk tha: Ata janë qafira, sepse e bëjnë qafirin musliman.

Në asnjërin prej këtyre llojeve të mospajtimeve nuk lejohet ta bëjmë qafir atë që nuk i thotë qafir atij që ne i kemi thënë qafir. Pse? Sepse s’kemi asnjë argument! Ngase ata thonë: Ne nuk e bëjmë qafir, sepse mendojmë që vepra në të cilën ka rënë nuk është kufër, apo në rastin e dytë: sepse mendojmë që filan personi ka pengesa për shpalljen e tij! E asnjëri prej tyre nuk e përgënjeshtrojnë fjalën e Allahut: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve.”**

Pastaj përdorimi i këtij rregulli në ata që thonë se janë muslimanë, është obligim i njeriut të vërtetë **domethënie** e fjalës së tij.

Për të qenë më të qartë themi: Sepse **domethënia e fjalës** së këtij që nuk i thotë qafir qafir nuk konsiderohet përgënjeshttrim i ajetit: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve.”**

Sepse domethënia (përmbajtja) e fjalës, nuk llogaritet fjalë (e shprehur), siç thotë Ibën Uthejmini, ngaqë nëse atij tjetrit që nuk e bën qafir filanin, i thua: “Fjala jote do të thotë se ti e përgënjeshtrojnë fjalën e Allahut: **“Kush kërkon fe tjetër pos Islamit, atij nuk do t’i pranohet dhe ai në Ditën e Gjykimit do të jetë prej të dështuarve.”** Ai të përgjigjet: Assesi, unë nuk e përgënjeshtroj fjalën e Allahut, por nuk i them filanit qafir sepse: Kjo nuk më takon

mua, sepse s’kam dituri, apo sepse nuk e di gjendjen e tij, apo sepse nuk mendoj që vepra në të cilën ka rënë është kufër, e kështu me radhë.

Prej argumenteve që i përforcojnë këto që thamë është se kur u pyet Aliu për havarixhët, a janë mushrikë apo jo? Ai tha: **“Jo, ata prej shirkut kanë ikur”**. Pastaj i thanë: Atëherë a janë munafikë? Tha: **Jo, munafikët e përmendin Allahun shumë pak**. Thanë: Atëherë çfarë janë ata? Ai tha: **Ata janë vëllezërit tanë, mirëpo kanë bërë zullum ndaj nesh**. (Ibën Ebi Shejbe, zinxhiri është i saktë.) Pra, Aliu nuk tha se janë qafira, edhe pse **domethënia** e fjalës së tyre ishte kufër, sepse ata i quajtën qafira sahabët, ndërsa **domethënia** e kësaj është: përgënjeshtrimi i ajeteve ku lavdërohen sahabët.

Nga kjo që thamë dalim në përfundimin se: Ky rregull vlen për ata që në thelb janë qafira, si të krishterët, çifutët, budistët etj., si dhe për ata që nuk e kanë thënë shehadetin dhe nuk shprehen se janë muslimanë, e jo për muslimanët, të cilët kanë rënë në ndonjë vepër kufri që rreth asaj ka mospajtim te dijetarët, siç e sqaruam më herët. Vetëm nëse ai që ka qenë musliman të pranojë ndonjë fe tjetër dhe ta deklarojë haptazi atë, si p.sh., të deklarojë haptazi se është i krishterë, në këtë rast dhe raste të ngjashme, ku kufri i tij është tepër i qartë hyn në rregullin e sipërpërmendur.

Prandaj në fund themi: Shpresojmë që ky shkrim modest do të ndikojë që vëllezërit tanë ta kuptojnë këtë rregull si duhet e mos ta keqpërdorin me vetëdije apo pa vetëdije. Lusim Allahun që të na mundësojë ta shohim të vërtetën si të vërtetë dhe ta pasojmë atë, dhe ta shohim të kotën si të kotë dhe të largohemi prej saj. Amin. ■

EURO 2008 DHE MUSLIMANËT

Ndeshjet finale të Kampionatit Evropian të futbollit që u zhvillua në qytetet e Zvicrës dhe Austrisë, edhe një herë tronditën dashmirët e sportit të futbollit. Ata gjithnjë e më tepër e dramatizuan edhe ashtu “dramën e madhe” EURO 2008

SHKRUAN: HAJRUSH MANI

Duke dashur te bëjmë një baraspeshë apo paralelizëm për dobitë dhe humbjet që ne si popullatë muslimane mund të kemi nga kampionati evropian që sapo mori fund, do të doja fillimisht të falënderoj Allahun



subhane ue teala për mundësinë që më dha të shkruaj këto rreshta.

Sporti është mjaft i dobishëm për njeriun, mirëpo duhet ditur se ne jemi të detyruar që ta shfrytëzojmë në mënyrë pozitive duke nxjerrë të mirat e punës që bëjmë gjatë stërvitjes apo edhe lojës.

Shumë njerëz në mbarë botën e priten me padurim fillimin e këtij evropiani, ndërsa edhe vetë muslimanët janë pjesë e botës dhe një numër i konsiderueshëm i tyre flasin me admirim për futbollin dhe aktorët që përbëjnë ekipet e ndryshme evropiane.

Duke marrë parasysh se tani një numër i madh i skuadrave janë të përbëra nga futbollistë me prejardhje të shteteve të ndryshme, por që kanë marrë shtetësinë e vendeve që janë forcë e madhe e futbollit, në radhët e tyre me ose pa dashje kanë futbollistë muslimanë. Nga ana tjetër disa ekipe kanë dhe futbollistë që me kohë janë konvertuar në fenë islame dhe janë shtyllë e ekipeve të tyre. Duke u bazuar në statistikat që kanë nxjerrë zyrtarët e Euro 2008, në listën e futbollistëve pjesëmarrës në këtë garë kishte një numër rekord të futbollistëve muslimanë, që morën pjesë në këtë Kampionat Evropian. Ky mund të jetë edhe një moment mjaft i mirë, që përmes futbollit muslimanët të pasqyrojnë sjelljen e tyre të mirë, saktësinë dhe dëshirën për punë.

Nëse shikojmë me shpejtësi skuadrat që garuan në Euro 2008 mund të hasim në më shumë se 10 futbollistë muslimanë që marrin pjesë në ekipet më të mëdha evropiane. Ndërmjet emrave muslimanë që përmendeshin në garat e Euro 2008 janë Frank (Bilal) Riberi, francez i cili u konvertua në musliman, Nikollas (Bilal) Anelka, francez i konvertuar në musliman, Robin Van Persi, futbollist holandez i cili konvertohet në musliman

“Në listën e futbollistëve pjesëmarrës në këtë garë kishte një numër rekord të futbollistëve muslimanë, që morën pjesë në këtë Kampionat Evropian...”

pasi që shoqërohet me fëmijë nga lagja (marokenë) dhe bashkëshortja e tij muslimane, Rami Shaban futbollist i kombëtares suedeze me origjinë egjiptiane, Khalid Bularuzh futbollist i përfaqësueses holandeze etj.

Siç e përmendëm dhe më lart këta futbollistë dhe shumë të tjerë, duke përfshirë këtu dhe përfaqësuesen turke që ka numrin më të madh të futbollistëve muslimanë, ata kanë një përgjegjësi të madhe që të jenë shembull e një skuadre kompetitive dhe korrekte. Franca si shteti i dytë në evropian me futbollistë muslimanë ka dëshmuar se mund të ketë lider në ekip që mund të sjellin shumë suksese.

Kjo do të ishte pjesa e parë e tekstit që ka të bëjë me aktorët e futbollit, të cilët edhe luajnë një rol pozitiv. Nga ana tjetër ku jemi të vendosur ne, të cilët ishim thjesht vëzhgues përmes ekranit televiziv, sa fituam ne nga Euro 2008 dhe manifestime të tjera sportive, sa mund të nxjerrim ne diçka pozitive nga kjo. Duke parë atmosferën që u krijua në vendin tonë mendoj se edhe në këtë rast ne kaluam kufijtë e normales, duke u bërë tifozë më të flaktë se vetë shtetasit të cilët kanë kombëtares e tyre në gara. Ne përsëri harrojmë se si muslimanë kemi

detyrime fetare edhe gjatë ndeshjeve të futbollit. Ne me sa duket harrojmë se mund t'i marrim shumë shpejt “viruset” dhe kurrsesi nuk mund t'u gjejmë atyre më pas ilaçin. Pasqyrë më e mirë e kësaj ishte faza e grupeve, kur gjatë ditës luheshin dy ndeshje ndërmjet orës 18 e deri në 22.30. Harronim se duhet të kemi kujdes ndaj namazit dhe se 90 minutat futbollistike kalojnë shpejt. Pikërisht do të përkujtojmë këtu ajetin kuranor ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim, zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë thahet dhe befaset e sheh të zverdhur, dhe pastaj mbetet e thyer e llomitur. Në Ahiret ju pret vuajtje e rëndë ose falje e Allahut dhe kënaqësi e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.”** (Hadidë, 20)

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim, zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë!”

E vështruar me kujdes, të gjitha veprat përveç adhurimeve dhe riteve fetare sillen rreth ndonjërit prej këtyre pesë boshteve kryesore. A thua vallë janë të ndaluara këto gjëra? Njeriu duhet të ketë

përherë një gjë parasysht në jetën e tij të përditshme, që të mos i ngatërrojë asnjëherë mjetet dhe qëllimet. Prandaj këto pesë gjëra mund të jenë të lejuara, nganjëherë edhe të preferuara, por herëherë të ndaluara, varësisht nga qëllimi i përdorimit të tyre. Pa dyshim se të gjitha punët vlerësohen në bazë të nijetit dhe futbolla nuk do të thosha se është i ndaluar në Islam. Mirëpo nuk është mirë dhe e rrugës që njerëzit të humbin veten me gjëra të kota dhe pa ose me dëshirë, apo dhe duke harruar flasin dhe fjalë që nuk janë të lejuara në Islam. Shpesh herë dëgjojmë shprehjen “unë adhuroj” filan lojtar, apo filan ekip, që padyshim është gabim dhe mëkat i madh.

Me fjalën e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: **“Punët shpërblehen sipas qëllimit”** nënkuptohet: **“Punët janë të vlefshme për atë që ka qëllimin e tyre të vlefshëm. Sa më i lartë të jetë qëllimi, po atë edhe puna është më e vlefshme. Gjithashtu puna është e pranuar apo jo, sipas qëllimit me të cilin e kryen vepruesi”**, ndërsa në këtë rast se sa ka qëllim të mirë në shikimin e futbollit pa kompromis më shumë se 90 minuta dhe duke harruar kohët e namazit apo punën e dhikrit, këtë punë ia lëmë Allahut subhane ue teala. Fundja ne duhet të jemi të kthjellët dhe të mendojmë se sa mund të fitojmë nga euoforia dhe “humbja” e kokës pas futbollit, pastaj ata që luajnë dhe vrapojnë në fund humbën apo fituan dalin fitimtarë, duke ditur se kanë profesion të vetëm futbollin, ndërsa ne do të japim llogari edhe për atë kohë që e kemi kaluar të humbur para TV, duke bërë tifo për ndonjë ekip. ■

“Punët janë të vlefshme për atë që ka qëllimin e tyre të vlefshëm. Sa më i lartë të jetë qëllimi, po atë edhe puna është më e vlefshme...”

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

MUHAMED HASEN JUSUF

Planifikimi strategjik është shfaqur si formë moderne e planifikimit në organizata. Ky lloj planifikimi ka shkaktuar ndryshime në mënyrën sipas të cilës organizatat i ngrejnë strategjitë e veçanta dhe i realizojnë ato.

Administrata strategjike është shndërruar në një mjet politik i organizatave për të mësuar dhe zhvilluar atëherë kur dëshirojnë të formësojnë gjendje të dallueshme dhe për t’iu përgjigjur efektivisht ndryshimeve globale, të cilat janë të shpejta dhe në shtim e sipër.

Shprehja “administratë strategjike” përdoret për të shprehur një nocion, i cili reflekton planifikimin strategjik. Edhe pse sektori privat është shumë para në këtë lloj planifikimi, përvoja na zbulon rëndësinë dhe efektivitetin e këtij lloji planifikimi edhe për organizatat publike. Administrimi strategjik na nxit që aktiviteti në organizata të realizohet sipas nocioneve të decentralizimit dhe autorizimit, krejt kjo

në një kornizë strategjike drejt orientimit në plane afatgjatë.¹

Çfarë është planifikimi strategjik?

Planifikimi strategjik është krijimi i zgjidhjeve të mundshme. Ky është një proces, i cili synon ndihmesën e liderëve për të qenë të vetëdijshëm për synimet dhe mjetet e tyre. Sipas kësaj planifikimi strategjik është mjet administrativ dhe përdoret vetëm për një qëllim, sikurse edhe mjetet tjera administrative, e ajo është ndihmesa e institucionit për ta realizuar punën në mënyrën më të mirë. Planifikimi strategjik mund ta ndihmojë organizatën që ta përqendrojë vëmendjen dhe prioritetet e veta, në mënyrën se si t’u përgjigjet ndryshimeve që ndodhin në mjedisin përreth dhe e siguron se individët e organizatës veprojnë drejt realizimit të synimeve të njëjta. Normalisht termi “strategjik” ka si qëllim t’i japë cilësinë e pikëpamjes afatgjatë dhe gjithëpërfshirës planifikimit.

E thënë shkurt planifikimin strategjik

¹ Jack Koteen, *Strategic Management in Public and Nonprofit Organizations*, 2nd edition. Westport, CT, USA: Greenwood Publishing Group, Inc., 1997. P: 20.

² Micheal Allison & Jude Kaye, *Strategic Planning for Nonprofit Organization: A Practical Guide and Workbook*, 2nd edition. NJ, USA: John Wiley & Sons, Inc., 2005. P: 1-2.



mund ta përkufizojmë kështu:

“Planifikimi strategjik është një proces sistemues brenda një organizate, të cilës i përmbahen pjesëmarrësit kryesorë në organizatë, i prioriteteve të cilat konsiderohen të domosdoshme për të arritur qëllimin e vet, dhe në të njëjtën kohë i përgjigjet mjedisit rrethues. Planifikimi strategjik të orienton në zotërimin e burimeve dhe përcaktimin e tyre drejt realizimit të prioriteteve“.²

Nga ky definicion mund të përqendrohemi në disa nocione për të qartësuar mënyrën e vendosjes së metodës së përshtatshme të planifikimit strategjik, duke ia shtuar edhe natyrën e vlerave dhe bindjeve tona drejt suksesit të procesit të planifikimit.

Planifikimi strategjik dallohet nga disa veçori, ku ndoshta më të rëndësishmet janë:

“Planifikimi strategjik të orienton në zotërimin e burimeve dhe përcaktimin e tyre drejt realizimit të prioriteteve” ...”

- Është proces i planifikimit strategjik, sepse ndërthet zgjedhjen e asaj që është më e mirë kundrejt situatave që formojnë një ambient dinamik, ndoshta në disa raste edhe armiqësor.

- Planifikimi strategjik është proces i sistemuar dhe të fton në pasimin e procesit sipas hierarkisë dhe fakteve.

- Planifikimi strategjik merret me të ardhmen dhe të ofron mundësinë e orientimit dhe administrimit të së ardhmes. Për këtë nuk detyrohesh të qëndrosh i ngrysur në vendin tënd, nëse ndonjë vendim merret gabimisht, ose nuk

merret ndonjë vendim i saktë, sepse mund të ndryshojnë tërësisht situatat e jashtme që të rrethojnë.

- Planifikimi strategjik është mjet për të menduar dhe për të lëvizur që të bësh një ndryshim të caktuar. Mendja administrative është mendja që merret me realizimin e qëllimit, prandaj nuk e kufizon veten tek hollësitë. Pranon t'i përmbahet planifikimit për të ardhmen dhe nuk mjaftohet vetëm të angazhohet me gjendjen në të cilën gjendet momentalisht. Llogarit shndërrimin e kornizës kohore të individit nga koha e tashme për në kohën e ardhshme, pastaj përsëri i kthehet kohës së tashme. Kjo konsiderohet shkathtësi strategjike, e cila mund të mësohet dhe të theksohet me stërvitje. Mendja strategjike pajtohet me ndryshimin dhe shpejt kalon nga problemi te përshkrimi i ilaçit shërues, pra, ajo vepron për të realizuar ndryshimin.

- Planifikimi strategjik është proces i vazhdueshëm dhe me kthim. Kontributi i administratës strategjike nuk mund të paraqesë aktivitet për një periudhë të caktuar kohore, ose të ketë fillim dhe mbarim, por duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe ku mbindërtohen përvojat dhe zhvillohen këto përvoja gjatë këtij procesi. Ndoshta njëri prej shkaqeve kryesore, që e sqarojnë vazhdimësinë e procesit të planifikimit strategjik është bashkëveprimi me situatat e jashtme, të cilat nuk ndalen asnjëherë, prandaj edhe planet dhe mjetet me të cilat realizohen ato plane duhet vazhdimisht të përmirësohen dhe të filtrohen.

- Administrimi strategjik paraqet një kornizë për orientimin e etapave të tjera të administrimit dhe nënkupton orientimin e disa detyrave administrative, sikurse janë përgatitja e programeve, përcaktimi i buxheteve për programet, vendosja e

“Administrimi strategjik nuk është proces që realizohet lehtësisht, por është një proces i rëndë, kërkon mund e kontribut intelektual dhe shumë disiplinë e rregull...”

hierarkisë, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe vlerësimi i tyre. Gjithashtu siguron udhëzimin për shndërrimin e burimeve dhe shkathtësive në aktivitetet me prioritet të lartë, domethënë përfshin përzgjedhjen e prioriteteve të caktuara.

- Administrimi strategjik nuk është proces që realizohet lehtësisht, por është një proces i rëndë, kërkon mund e kontribut intelektual dhe shumë disiplinë e rregull. Gjithashtu ka nevojë për vullnet dhe shkathtësi për të zgjedhur afatet kohore për realizimin e tyre, në vend të pritjes së ndodhive dhe krizave që na shtojnë për të reaguar në mënyrë sterile. Në shumë raste pritja, për shkak se nuk jemi të sigurt se çfarë duhet të bëjmë, na vonon shumë në marrjen e ndonjë vendimi efektiv, madje edhe na shpie në shumë rezultate negative.

Për shkak të rëndësisë së madhe që i jepet planifikimit strategjik në kohën tonë, po vërejmë se shumë programe për vetëzhvillim kanë filluar të realizojnë këtë mënyrë për zhvillimin individual dhe ngritjen profesionale. ■

Përktheu: Bekir Halimi



SHARJET MË TË RËNDA

AMIR DURMIÇ

Në botë mbretëron një eufori globale antiislame. Islami sulmohet fuqishëm dhe në mënyrë të organizuar, me një ritëm që me siguri është më i fuqishmi dhe më i ashpri deri tani. Kjo madje u është bërë e qartë të gjithëve. Më asgjë nuk bëhet me “dorëza”. Të gjitha maskat kanë rënë. Sulmet e sinkronizuara ndaj Islamit si fe dhe ndaj të gjitha të shenjtave të tij tashmë janë bërë preokupim global i shumë organizatave, individëve të fortë, të gjitha llojet e medieve, por madje mund të themi edhe të politikës së

shumë shteteve. Edhe në qoftë se nuk bëjnë politikë të qartë dhe të haptë antiislame, shumë aparate shtetërore nuk bëjnë asgjë për të penguar sjelljen e pandërgjegjshme të shtetasve të tyre, ose të tërë organizatave që veprojnë në to, e të cilat janë të preokupuara me të gjitha llojet e shfaqjes së urrejtjes ndaj Islamit dhe myslimanëve. Shembullin më brengosës e kemi në disa shtete skandinave dhe në Holandë. Ato sot më mirë se kurrë e kanë vërtetuar konstatimin e Shekspirit tek vepra e tij Hamleti: “Diçka është kalbur në shtetin danez.”

Me lejimin e tyre të shprehur publikisht, ose me heshtjen e shfaqur ndaj karikaturave të diskutueshme, si dhe të filmit “Fitne”, këto shtete kanë treguar se i prijnë kolektivisht urrejtjes ndaj Islamit, ndërsa përrallat e tyre për gjoja lirinë e shprehjes le t’i mbajnë për vete. Në qoftë se gjithkush ka të drejtë të flasë dhe të përhapë publikisht atë që i bie ndërmend, pa marrë parasysh sesa butësisht dhe në mënyrë tërheqëse anon personi, atëherë nuk bëhet fjalë për lirinë e shtypit ose të mendimit, por më shumë bëhet fjalë për anarkinë informative, apo për terrorizmin mediatik, pasojat e të cilave i vuajnë dhe i ndjejnë sot më shumë mbi supet e tyre myslimanët.

Muslimanët e vetëdijshëm

Të gjithë myslimanët e vetëdijshëm janë të zemëruar për këtë eufori antiislame dhe kështu duhet edhe të jetë. Mirëpo sjelljet që i ndërmarrin ndonjëherë për shkak të revoltës ndaj kësaj gjendjeje shpeshherë nuk janë të matura, as që mendohet për pasojat e mundshme, të cilat në të shumtën e

“... Ato sot më mirë se kurrë e kanë vërtetuar konstatimin e Shekspirit tek vepra e tij Hamleti: “Diçka është kalbur në shtetin danez...”

rasteve sjellin më shumë dëm sesa dobi. Pra, duhet reaguuar, ndërsa përvoja tregon se reagimi më frytdhënës është injorimi total i këtyre provokimeve të ulëta, duke dhënë kontributin maksimal që të gjitha burimet dhe potencialet që disponon umeti musliman t’i drejtojnë nga afirmimi i vlerave Islame dhe ofrimi i fesë së Allahut subhanehu ue teala, atyre që janë të ditur dhe të mençur, e tek të cilët nuk ka arritur akoma drita e udhëzimit të Allahut subhanehu ue teala. Por ta lëmë Danimarkën dhe Holandën. Tek ne kemi raste të shpeshta të lexojmë ose dëgjojmë fjalë të rënda dhe ofenduese në llogari të Islamit dhe disa parimeve të tij, këto nga ana e atyre që kanë “dalë nga dimitë”, ndërsa disa të tjerë mbartin edhe emra të Pejgamberëve të Allahut subhanehu ue teala.

Format më të shpeshta të ofendimit të Islamit

Sa i përket jetës së përditshme, forma më e shpeshtë e ofendimit të Islamit është fyerja e Allahut subhanehu ue teala, Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, Kuranit Famëlartë, xhamive, si edhe të gjitha shenjtërive të tjera Islame. Sharja dhe nënçmimi i shenjtërive Islame llogaritet mosbesim i haptë dhe i qartë, gjë për të cilën tek dijetarët myslimanë nuk ka kurrfarë dileme.

Allahu subhanehu ue teala në Kuran na lajmëron për gjendjen e atij grupi njerëzish, që e kanë sharë Allahun subhanehu ue teala, dhe Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Këto “shaka” kanë ndodhur në llogari të disa sahabëve gjatë kohës së nisjes për në Tebuk, duke thënë se ata janë gënjeshtarë, qyqarë dhe se i kanë stomakët e mëdhenj, e për këtë Allahu subhanehu ue teala, për këta njerëz tha: **“E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: “Ne vetëm jemi mahnitur e dëfryer”. Thuaj: “A me Allahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?” Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat keni mohuar. Nëse një grup nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë.”** (Teube, 65-66)

Me siguri që nuk ekziston ndonjë popull tjetër në botë që shan më keq dhe më shëmtueshëm sesa populli i Ballkanit. Sharja për shumicën e tyre është bërë kult. Nuk janë të rralla, as edhe garat e të rinjve të lugatosur në të cilat vlerësohen “sharjet më të forta”, ndërsa sharjet dhe ofendimet mohuese ndaj Zotit dalin nga gojët e tyre të shëmtuara. Të rinj dhe të reja, po bile edhe persona të pjekur dhe pleq, me mendje të mpirë dhe pa kurrfarë lloj kulture dhe edukate, e shajnë Zotin, ashtu për kot e kot, qofshin të hidhëruar apo të disponuar, e një sharje e këtillë u vjen sikurse një lloj mbështetje dhe shkak, ndërsa shumicës u është bërë si një parazit gjuhësor, gjë për të cilën ndoshta edhe nuk janë të vetëdijshëm. Në qytete kohëve të fundit, por edhe në vendet rurale, mjafton vetëm që të shëtitësh nëpër qendrën e qytetit, parkun e shkollës, treg ose çfarëdo tubimi tjetër të njerëzve, e të dëgjosh sharje dhe ofendime të shenjtërive Islame, saqë çdo njeriu të

edukuar dhe të kulturuar thjeshtë i vjen për të vjellë nga sasia e pakulturës aktuale, por edhe mund të supozojmë se ai person nuk është aspak musliman. Kur një mikro krijesë e quajtur (jo) njeri, i cili në krahasim, le të themi me Diellin mund të llogaritet edhe më i vogël sesa një pjesë e atomit, merr guxim të shajë dhe të ofendojë Allahun subhanehu ue teala, Krijuesin Absolut dhe Zotin e gjithësisë, atëherë nuk ka dyshim se bëhet fjalë për kulmin e mendjemadhësisë dhe urrejtjes ndaj gjithçkaje që meriton të respektohet. Një nga fenomenet që është vërejtur kur bëhet fjalë për këtë paraqitje është fakti se Allahun subhanehu ue teala, Kuranin dhe xhamitë i shajnë ata në qafët e të cilëve varen gjysmëhëna dhe ylli, si argument i krenarisë së përkatësisë Islame, dhe që “krenohen” me muslimanllëkun e tyre. Në qoftë se këtyre njerëzve u kundërvihemi apo i paralajmërojmë se kjo lloj sjellje është vepër mosbesimi, këta shpesh hidhërohen ose bëhen edhe më agresivë, duke konstatuar se ata janë “muslimanët e vërtetë” dhe se zemrat i kanë të pastra, e jo “sikurse ju, disa të rinj...” Allahu subhanehu ue teala, na ruajt nga “pastërtia dhe virtytet” e zemrave të

“...duhet të nisemi me fjalë të mira dhe këshilla, duke theksuar se me sharje nuk arrihet kurrfarë dobie në këtë botë, as që kënaqet ndonjë ëndje trupore...”

këtilla, të cilat mund të jenë gjithçka tjetër përveç se zemra të pastra.

Ku është zgjidhja

Në qoftë se ngrihet pyetja se në çfarë mënyre ta përmirësojmë këtë lloj të problemi në vendet tona, përgjigjja i është lënë çdo individ i në vete, sepse rrethanat ndryshojnë. Gjithsesi së pari ne duhet të nisemi me fjalë të mira dhe këshilla, duke theksuar se me sharje nuk arrihet kurrfarë dobie në këtë botë, as që kënaqet ndonjë ëndje trupore, që është një nga shumë mëkatet e tjera, siç janë vjedhja, gënjeshtria, zinaja etj. Përveç kësaj e dimë nga përvoja, se fjala e bukur mund të jetë si një “prerje me thikë” dhe në vend të falënderimit për këshillën, sharësi do të ta kthejë me një sharje edhe më të rëndë dhe më të shëmtuar, ndërsa këshilluesi i sinqertë duhet të largohet sa më shpejt nga “vendi i krimit”, që të mos dëgjojë më tej ato fjalë nga të cilat do t’i ngrihej gjaku nëpër vena. Ai që e refuzon këshillën dhe vazhdon të shajë gjithçka që i bie ndërmend, duke mos kursyer gjatë kësaj kohe, as edhe shenjtëritë Islame, dhe vdes si i tillë pa kurrfarë pendimi të sinqertë, le ta dijë se nga hidhërimi i Allahut subhanehu ue teal, nuk do të mund ta shpëtojë kurrfarë duaje, recitimi Kurani, hajmalie, tesbihi në shtatë dhe dyzet ditë, as mijëra eurot e shpenzuara për përmendore mbi varr, të cilën do t’ia ndërtojnë të vdekurit familjarët e tij.

Veprat të bëjnë besimtar

Ebu Derda, radijallahu anhu, një nga sahabët fisnikë të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, i kishte shkruar një letër Selman Farisiut radijallahu anhu, po

ashtu një tjetër sahab i ndershëm dhe fisnik, duke e porositur që të shpërngulet në Tokën e Shenjtë, ndërsa ai me mençuri i ishte përgjigjur: **“Me të vërtetë Toka e shenjtë nuk e bekon atë që në të jeton. Njeriun e bekojnë veprat e tij.”** (El-Muvetta, Imam Malik, 2/235). Porosia që duhet të nxjerri populli ynë nga ky transmetim i mençur dhe i urtë është se banimi dhe qëndrimi i ndonjë muslimani në Mekë, Medinë apo Palestinë (Kuds), kjo gjë atë nuk do ta bënte aspak më të zgjedhur, ose më të vlefshëm tek Allahu subhanehu ue teal, nga të tjerët, përveç në qoftë se beson dhe bën vepra të mira. Po ashtu asnjërin nuk e bën musliman prejardhja, emri apo gjysmëhëna dhe ylli rreth qafës së tij, por musliman e bën bindja e vet, të cilën e mbart në zemër dhe të cilën e shfaq me gjymtyrët dhe veprat e tij. Njeriu që e shan në mënyrë të vazhdueshme Allahun subhanehu ue teal, dhe me tërë fuqitë e tija mundohet që të nënvlerësojë gjithçka që Islami e llogarit për të shenjtë, nuk mund të llogaritet si besimtar, pa marrë parasysh se sa haxhinj ka në familjen e vet, se sa herë e ka bërë hatme Kuranin dhe sa Kuranë të mbështjellë me pëlhura ka vendosur në vitrinat e shtëpisë së tij.

Secili para Zotit do të dalë vetëm dhe do të përgjigjet personalisht për (jo) veprat e tij, atë Ditë kur: **“Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar.”** (Nur, 24), **“Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët.** (bën dobi) **Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”** (Shuara, 88-89). ■

**Nga boshnjakishtja:
Sabahudin Fetahu**

SHPËTIMI NGA PASURIA HARAM, SIÇ ËSHTË KAMATA



SHEJH HALID EL-MUHENA

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë vetëm Allahut, Atij i jemi mirënjohës dhe nga Ai ndihmë dhe falje kërkojmë. Tek Allahu kërkojmë mbrojtje nga të këqijat e vetes dhe të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu s'ka kush ta devijojë dhe atë që e devijon, s'ka udhëzues tjetër për të. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Allahut. Paqja e bekimi qofshin

mbi të, familjen e tij dhe shokët e tij deri në Ditën e Kiametit, atëherë:

E lus Allahun të na përkrahë në dynja dhe ahiret, të na bëjë prej atyre që kur u jepet diçka – falënderojnë, kur u ndodhin sprova durojnë dhe kur mëkatojnë – falje kërkojnë.

Prej çështjeve që po përmendet shpesh sot është edhe çështja sesi të çlirohemi nga paratë e kamatës, kur ato na bien në duar. Kjo ndodh për shkak të përhapjes së madhe të bashkëpunimit me kamatën, madje ndonjëherë as që mundesh t'i shpëtosh – Allahu na ndihmoftë. Desha t'i përmbledh

mendimet e dijetarëve për këtë temë dhe të arrij në atë që do ta lexoni më poshtë. Prandaj, nëse kam gabuar apo harruar diçka, ajo është për shkakun tim dhe të djallit, ndërsa Allahu dhe i Dërguari janë larg asaj, e aty ku e kam qëlluar është vetëm dhunti e Allahut.

Si të çlirohemi nga pasuria haram, siç është ajo e kamatës:

Ai që arrin të ketë një pasuri të ndaluar, siç është ajo e kamatës, është i detyruar që të çlirohet sa më parë nga ajo pasuri, sepse ajo është fituar në mënyrë jo të lejuar. Argumentet nga Kurani dhe Suneti, që na e mësojnë këtë gjë janë të shumta, po ashtu edhe prej gjeneratave të para përcillen thënie të tilla, siç është rasti me dijetarin ez-Zuhri, kur e pyetën për një njeri që fitonte pasuri edhe me haram, ai u përgjigj: Nëse ai njeri dëshiron të shpëtojë, atëherë le të ndajë një pjesë nga ajo pasuri.

Përcaktimi i sasisë që duhet ndarë ka dy gjendje:

Një: Nëse e di sasinë e pasurisë haram saktësisht duhet ta ndajë të tërën, ashtu si është.

Dy: Nëse nuk e di sasinë dhe përzihet së bashku me pasurinë tjetër, atëherë mundohet të bëjë një llogari dhe të ndajë një sasi.

Kjo çështje degëzohet dhe kjo në:

Dega e parë: Dijetarët e Jurisprudencës Islame janë pajtuar se – me sa kam lexuar – myslimanit nuk i lejohet të ketë në pronësinë e vet të holla nga kamata dhe nuk duhet t'i mbajë me vete, madje nëse e njeh pronarin e atyre të hollave duhet t'ia kthejë atij. Por ata kanë mendime të ndryshme për rastet kur pronari i atyre parave është i panjohur, a lejohet t'i përdorë ato, apo nuk guxon të bëjë asgjë me to. Rreth kësaj kemi dy mendime.

Mendimi i parë: E ka të lejuar ta përdorë atë pasuri, në pajtim me rregullat e shariatit. Këtë mendim e përkrahin shumica e dijetarëve hanefij, malikij, shafij dhe hanbelij.

Mendimi i dytë: Duhet ta ruajë atë pasuri

“...myslimanit nuk i lejohet të ketë në pronësinë e vet të holla nga kamata dhe nuk duhet t'i mbajë me vete, madje nëse e njeh pronarin e atyre të hollave duhet t'ia kthejë atij...”

dhe nuk guxon ta përdorë atë. Ky mendim i përshkruhet Imam Shafiut.

Argumentet e mendimit të parë:

1. Asim b. Kulejb përcjell nga i ati, e ai nga njëri prej ensarëve, i cili rrëfen: “Dolëm së bashku me të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, në një xhenaze dhe e shihja Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, ndërsa qëndronte pranë varrit i sugjeronte hapësit të varrit: “Zgjeroje nga ana e këmbëve, zgjeroje nga ana e kokës”, kur u kthye, dikush e ftoi në emër të një gruaje dhe ai pranoi. E sollën ushqimin dhe ai zgjati dorën për të marrë e po ashtu edhe shokët e tij, të cilët edhe hëngrën, ndërsa i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, mbeti duket përtypur kafshatën në gojë dhe tha: “Mua më duket se kjo dele është marrë pa lejen e pronarëve të tij”. Atëherë gruaja dërgoi arsyetimin e saj: *O i Dërguar, unë porosita që të më blihet një dele nga tregu i Bekias, por nuk kishte, atëherë çova fjalë te komshiu, i cili kishte blerë një dele të ma shesë atë me të njëjtin çmim, por ai nuk u pajtua, atëherë i çova fjalë shoqes së tij, e ajo ma dha delen. Në këtë rast i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, tha: Le të hanë robërit nga ky ushqim”.* (Sahih Ebu Davud nr. 3332). Argumentimi nga ky hadith bëhet asisoj që i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, këtë mish të pjekur që ishte i vjedhur, urdhëroi të përdoret në një formë

tjetër e nuk urdhëroi që të asgjësohet, përkundrazi të ruhet dhe të përdoret në mënyrë të lejuar.

Prandaj pasuria e fituar në mënyrë të ndaluar lejohet të përdoret në atë mënyrë duke e shpenzuar në dobi të përgjithshme, ndërsa ai që i ka në dorë ato të holla, nuk lejohet t'i përdorë për vete.

2. Ngjarja e kaullit që Ebu Bekri, radijallahu anhu, bëri me jobesimtarët pas zbritjes së ajetit: **“Elif, lam, mim. U mundën bizantinët, në afërsi të tokës (arabe), por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë.”** (Rum 1-3). Ky kaull u bë me lejen e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, dhe u vërtetua se Ebu Bekri kishte të drejtë. Pasurinë që e mori nga kaulli me jobesimtarët e solli te Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, dhe ai i tha: **“Shpërndaje si sadaka”** (sahih). Por, ndalesa për kaullin zbriti pas kësaj ngjarje, të cilën e lejoi Resulullahu, salallahu alejhi ue selem.

3. Na përcillet se Ibën Mesudi, radijallahu anhu, kishte marrë një robëreshë, por nuk e gjeti pronarin, që t'ia dorëzojë të hollat, e kërkoi shumë por nuk e gjeti dot. Atëherë atë shumë të hollash e dha sadaka dhe tha: **“O Allahu im, këto janë në emër të pronarit nëse ai pajtohet, e nëse jo, shpërbli mi të mbetet për mua”**.

4. Kur pamundësohet kthimi i pasurisë ose pronari është i panjohur, atëherë themi se i panjohuri është i barabartë me atë që nuk ekziston. Këtë e mësojmë edhe nga fjala e Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, kur flet për sendet e gjetura: **“Nëse takon pronarin e tij, ia kthen atij, por nëse jo, atëherë ajo është nga pasuria e Allahut, të cilën ia jep atij që do”**. Argumentimi nga ky hadith bëhet kështu, se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, në këtë rast shpjegoi se sendi i gjetur, i cili ka ikur nga dora e pronarit pa pëlqimin e tij, sërish mbetet pronë e pronarit, e nëse nuk gjendet pronari, atëherë Allahu ia dhuron këtë pasuri atij që e ka gjetur në mënyrë të lejuar.

5. Nuk lejohet që një pasuri të asgjësohet apo të hidhet në det, pra, nuk mbetet ndonjë mundësi më e mirë, sesa të shfrytëzohet në dobi të përgjithshme për myslimanët.

6. “Myslmanët janë të pajtimit se ai që vdes dhe nuk njihet se ka ndonjë trashëgues, malli i tij duhet të shpenzohet në dobi të përgjithshme, edhe pse në këtë botë të madhe mund të ketë ai njeri dikë të largët nga familja, mirëpo përderisa nuk dihet është njësoj sikur të mos ekzistojë”.

7. “Këto lloj pasurish nuk kanë mundësi tjetër përveçse të depozitohen (bllokohen), të asgjësohen ose të shpenzohen.

Asgjësimi i tyre është humbje e kotë dhe çrregullim, ndërsa Allahu nuk e do çrregullimin dhe Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, e ka ndaluar që të humbet pasuria kot.

Po ashtu bllokimi i një pasurie përgjithmonë deri në një afat të pacaktuar, madje duke pasur bindjen se ato të holla nuk do të arrijnë asnjëherë te vetë pronari, kjo konsiderohet po ashtu sikurse asgjësimi i tyre. Asgjësimi është i ndaluar, sepse në atë mënyrë i pengon njerëzit të përfitojnë nga ajo pasuri, e njëjta gjë ndodh edhe me bllokimin e asaj pasurie, madje bllokimi është edhe më keq për dy arsye:

E para: Sepse i keqtrajton njerëzit kur e bllokon një pasuri për të cilën ata kanë nevojë.

E dyta: Sepse dihet zakonisht, një ditë prej ditëve doemos kjo pasuri do të bjerë në duart e njerëzve të padrejtë, nëse të drejtit nuk e shpenzojnë atë. Pra, nëse e bllokojmë një pasuri, ne ndihmojmë tërthorazi që kriminelët të manipulojnë me të dhe në këtë mënyrë: njerëzit e drejtë i pengojmë, ndërsa kriminelëve u ndihmojmë. Këtu s'është me rëndësi e ke pasur këtë qëllim apo jo, sepse ai që e lë mishin pranë kafshëve të egra, konsiderohet sikur t'ua ketë dhënë dhe ai që bllokon shumën të mëdha parash, konsiderohet sikur t'ua ketë falur atyre.

Prandaj, përderisa asgjësimi i të hollave

është i ndaluar, ndërsa bllokimi është edhe më i keq, atëherë na del si detyrë që ta shpenzojmë. Ku duhet shpenzuar nuk është e përcaktuar, por mund të shpenzohen në çdo lloj bamirësie dhe në gjëra me të cilat njeriu afrohet tek Allahu i Madhëruar. Sepse Ai, i ka krijuar krijesat që ta adhurojnë dhe u ka dhënë pasuri që ta kenë më të lehtë ta adhurojnë, prandaj ato pasuri mund të shfrytëzohen për hir të Allahut. Allahu e di më së miri”. (Këtë e ka thënë Shejhul Islam Ibën Tejmije në librin e tij el-Fetava el-Kubra, por këtu e keni në version të shkurtuar 4/210-213)

Argumentet e mendimit të dytë:

1. Ajeti: **“O besimtarë! Shpenzoni nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur...”** (Bekare 267).

2. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, rrëfen se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Allahu është i mirë dhe përveç të mirës nuk pranon. Allahu i ka urdhëruar besimtarët njësoj siç i ka urdhëruar pejgamberët, Ai ka thënë: “O pejgamberë, hani prej të mirave dhe veproni punë të mira, Unë jam i mirënjohur për atë që punoni”.** (Muminun 15) dhe ka thënë: **“O besimtarë, hani prej të mirave që u kemi furnizuar”.** (Bekare 172) dhe pas kësaj përmendi njeriun që ishte në një udhëtim të gjatë, i pluhurosur dhe i parregulluar, që ngriti duart nga qielli duke u lutur: **O Zot, O Zot, por ushqimi i tij ishte nga harami, pija e tij nga harami, veshja nga harami dhe kishte ngrënë haramin, e si t’i përgjigjej Allahu atij?!”** (Muslimi nr. 2346)

3. Ibën Mesudi radijallahu anhu, rrëfen se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“...Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, kushdo që fiton të holla nga harami dhe i shpenzon ato, nuk do të ketë bereqet, kushdo që i jep lëmshë nuk do t’i pranohet ajo...”** (Ahmed Shakiri në Umdetu Tefsir 1/323

thotë se hadithi është sahih).

Mënyra e argumentimit me këto argumente është se Allahu është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Ai nuk pranon asnjë lëmshë, përveç lëmshës që është dhënë nga një pasuri hallall, që është fituar në mënyrë të lejuar. Si dhe shpenzimi i pasurisë hallall është kusht i pranimit të veprave të mira, gjë që do të thotë se ai që shpenzon pasurinë haram, nuk ka asnjë shpërblim për këtë.

Këtij argumenti i është përgjigjur Imam Gazaliu: **“Ai që thotë se sadaka japim vetëm nga pasuria hallall, i themi: ashtu është kur duam dhe shpresojmë sevape, ndërsa tani jemi duke u munduar të lirohemi nga zullumi dhe nuk po kërkojmë shpërblimin. Ishim në dyshim ta asgjësojmë këtë pasuri apo ta japim sadaka dhe më e udhës na doli që ta japim sadaka dhe jo ta asgjësojmë. Ndërsa ai që thotë: Atë që nuk e duam për vete, nuk e duam as për tjetrin, i themi: ashtu është, mirëpo për ne ato të holla janë haram, sepse nuk kemi nevojë për to, ndërsa për të varfrin janë hallall, kur këtë e thotë argumenti fetar. Nëse dobia kërkon që kjo të jetë hallall ashtu dhe duhet të bëhet”.**

Mendimi më i vërtetë është mendimi i parë, për shkak të argumenteve të forta dhe marrjes parasysh të dobive që promovon sheriati. Ndërsa ata të mendimit të dytë nuk kanë ndonjë argument të fortë, konkret për këtë çështje.

(në numrin e ardhshëm vazhdon me pikat: Dega e dytë: Mënyra konkrete si të çlirohemi nga të hollat e kamatës

Dega e tretë: Kush duhet të marri përsipër ndarjen e të hollave të kamatës

Dega e katërt: Nëse dihet se kamatëdhënësi merret vazhdimisht me kamatë dhe po qe se ia kthejmë të hollat e kamatës, kjo nuk do të ndryshojë asgjë, si t’ia bëjmë në këtë rast?) ■

Përktheu: Omer Berisha

FORCA LËVIZËSE E SJELLJES SË NJERIUT

MOTIVET¹

A njeh ndokënd që ka pasur një vend pune të shkëlqyer dhe pagesë të mirë, mirëpo e ka braktisur punën e tij vetëm për arsyen se nuk ka pasur motive të mjaftueshme për punë?

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Kur ti zotëron në vetvete motive, arsye dhe shtytës, edhe entuziazmin do ta kesh më të madh, kapacitet më të shumtë dhe arritjet e tua do të jenë më të larta. Në të kundërtën, kur synimet i ke të ulëta, nuk do të zotërosh forcë dhe kapacitet, si dhe përqendrimi dhe vëmendja e interesit tënd

do të drejtohet vetëm nga gjërat negative. Në fund rezultati do të jetë mosefikasiteti në përmbushjen e detyrave.

Një herë një i ri shkoi te një plak i urtë për të mësuar prej tij sekretin e suksesit dhe e pyet: “A ke mundësi të më tregosh për fshehtësinë e suksesit?” Njeriu i mençur i përgjigjet me qetësi: “Fshehtësia e suksesit janë motivet.” I riu e pyet: “Nga vijnë motivet?” Urtaku i përgjigjet: “Nga pasionet



¹ Motivi është shkaku që nxit dhe vë në lëvizje dikë për të bërë diçka; arsyeja që të shtyn për një veprim, ose për një qëndrim a sjellje të caktuar.

e tua të zjarrra.” Djaloshi i habitur ia kthen: “E si ngjallen tek ne këto pasione të zjarrra?” Plaku i kërkon falje djaloshtit për një minutë dhe kthehet duke sjellë me vete një enë të madhe të mbushur me ujë dhe e pyet: “A je i sigurt se me të vërtetë dëshiron të dish burimin e pasioneve të zjarrra?” I riu përgjigjet me plot bindje: “Po, gjithsesi.” Plaku kërkon nga i riu që të afrohet dhe ta shikojë enën me ujë. Pasi djaloshi i hedh një shikim ujit, plaku papritmas ia kap kokën djaloshtit dhe me tërë forcën ia fut kokën me të dy duart në ujë!” Megjithëse sekondat kalonin, plaku nuk ia lëshonte kokën djaloshtit, ndërsa ky mundohej ta ngrinte atë lart. Kur nisi t’i zihej fryma, filloi të rezistojë me një forcë të madhe derisa arriti ta shpëtonte veten dhe ta nxirrte kokën nga uji. Paskëtaj i nervozuar i drejtohet plakut: “Çfarë është kjo që bërë?” Plaku i urtë me qetësi, duke i buzëqeshur e pyet: “Po ti ç’mësove nga e tëra kjo?” Djaloshi i mllëfosur i thotë: “Asgjë.” Plaku i thotë: “Jo, biri im ti ke mësuar shumë. Në sekondat e para dëshirove ta nxirrje kokën nga uji, mirëpo motivet e tua nuk e kishin arritur shkallën më të lartë, ndërsa nga fundi te ti u ndez pasioni i zjarrrë që ta shpëtosh veten dhe vetëm atëherë ia dole me sukses, për arsye se në ato momente nuk pati asnjë forcë që të ndalë ty.” Në fund plaku i urtë i drejtohet djaloshtit dhe i thotë: “Nëse ke dëshirë të zjarrrë për të korrur sukses, me lejen e Zotit askush nuk ka mundësi që të të ndalë.”

Nga kjo ngjarje përfitojmë se dëshira e madhe për diçka është parimi i parë i suksesit, sepse ajo është farë që mbillet në tokën e suksesit, ndërsa sekreti i suksesit është pasioni i zjarrrë. Për të kuptuar këtë gjë duhen sqaruar se ekzistojnë tri lloje motivesh:

I. Motivi i mbijetesës (ekzistencës)

Motivi i mbijetesës është ai që e detyron

“Nëse ke dëshirë të zjarrrë për të korrur sukses, me lejen e Zotit askush nuk ka mundësi që të të ndalë...”

njeriun t’i plotësojë nevojat e tij elementare si: ushqimi, uji dhe ajri. Në momentin kur paraqitet mungesa e njëres prej këtyre nevojave elementare, brenda njeriut aktivizohet motivi qendror, i cili vë në alarm sistemin vegetativ në tru, duke e lajmëruar për këtë mungesë. Në saje të lëvizjes së shpejtë nëpër qeliza, trupi i njeriut vihet në veprim duke u bërë aktiv dhe tek ai paraqitet motivi për të vepruar, ajo që kërkohet për plotësimin e kësaj mungese. Pasi realizohet kjo, atëherë trupi kthehet në gjendjen e tij të natyrshme.

Le ta ilustruim këtë me një shembull: Në xhungël ekziston një tipar i përbashkët ndërmjet luanit dhe gazelës. Në mëngjes secili prej tyre fillon të vrapojë me shpejtësi. Luani ka parasysh se duhet të vrapojë më shumë sesa gazela, ose përndryshe do të vdesi nga uria. Në anën tjetër gazela e di se duhet të vrapojë më shpejt se luani, ose në të kundërtën do të jetë viktimi e tij, edhe pse ndonjëherë nuk ekziston dëshira e ndonjërit prej tyre për të vrapuar, mirëpo që të dy patjetër duhet të vrapojnë sa më shpejt për të mbijetuar.

Lexues i dashur më lejo të të pyes një gjë: Kur je duke e kaluar rrugën dhe makinat lëvizin me shpejtësi të madhe dhe rastësisht një automjet vjen në drejtimin tënd me shpejtësi, si do të jetë reagimi yt? Sigurisht që do të vraposh me shpejtësi të madhe, apo jo? Kur kthehesh në shtëpi pas një dite të mundimshme dhe nuk ke forcë për të kryer më asnjë punë, ti vendos që të pushosh para ekranit televiziv, mirëpo befasisht dëgjon

dikë duke bërë titull: zjarr, zjarr, si do të jetë reagimi yt? Pa dyshim që do ta braktisësh shtëpinë tënde sa më shpejt!!! Shtrohet pyetja, prej nga shfaqet kjo energji dhe forcë, e cila pak çaste më parë ishte inekzistente te ti?

Në bazë të kësaj mund të themi se pa marrë parasysh, se si është mënyra jote e jetesës, në momentin kur të kërcënohet ekzistenca do të zgjohesh dhe entuziazmi yt do të arrijë kulmin, me qëllim që ta shpëtosh veten. Paramendo sikur ky pasion të ishte përherë i pranishëm te ti, kush do të ishte fuqia dhe kapaciteti yt; si dhe sa e sa rezultate të shkëlqyera do të arrije në sja të kësaj.

II Motivet e jashtme

Këto lloj motivesh e kanë burimin në botën e jashtme, si p.sh.: ndonjë ligjërues i shkëlqyer, shok, pjesëtar i familjes, revistë, libër apo drejtori në punë... etj. Problemi i motiveve të jashtme është se ato zhduken shumë shpejt.

A ju ka ndodhur ndonjëherë të jeni i pranishëm në ndonjë ligjëratë fetare, me qëllim që t'i aktivizoni dhe t'i veni në veprim motivet personale.

Nëse përgjigjja është po... sa ishte sasia e entuziazmit tënd pas një jave, pas një muaji ose pas gjashtë muajve? S'ka dyshim se shkalla e entuziazmit është në rënie, a nuk është kështu?

Fatkeqësisht njeriu mbështetet shumë në motivet e jashtme, përderisa ndjen respektin dhe vlerësimin e menaxherit, e shokëve ose pjesëtarëve të familjes. Ne gjithmonë kemi nevojë për të arritur kënaqësinë e të tjerëve, të nderohemi, të jemi të respektuar, deri në atë masë sa ne të ndihemi të vlefshëm. Kjo është arsyeja përse ne nganjëherë bëjmë veprime, të cilat nuk përshtaten me dëshirat tona dhe që nuk burojnë prej nesh.

Përkitazi me këtë një mendimtar ka thënë: "Pikëpamjet e njerëzve ndaj nesh janë

ato që na shkatërrojnë. Po të ishin të gjithë ata që më rrethojnë të verbër, nuk do të kisha nevojë për rroba ekstravagante e as për shtëpi të bukur dhe mobilie luksoze."

Mund të konkludojmë se ajo që aspron njeriu i ngritur gjendet në veten e tij, ndërsa atë që lakmon njeriu i thjeshtë e sheh te të tjerët.

III Motivet e brendshme

Këto lloj motivesh janë më të rëndësishmit dhe më të qëndrueshmit, sepse me këto njeriu udhëhiqet nga forcat brenda unit të tij, të cilat e shpijnë drejt realizimit të rezultateve të larta.

Më lejo të të shtroj një pyetje: Nëse ke pasion të stërvitësh në ndonjë klub sportiv dhe ke bërë marrëveshje me ndonjërin prej shokëve të tu për të të shoqëruar në stërvitje. Në momentin e fundit edhe përkundër marrëveshjes, shoku yt tërhiqet dhe e anulon takimin. A do të shkosh vetëm në stërvitje apo do ta anulosh edhe ti stërvitjen. Motivet e tua të brendshme të nxisin se stërvitja do të ta forcoj trupin, shëndeti yt do të jetë më i mirë dhe shkalla e forcës do të të rritet. Motivet e tua të brendshme do të të nxisin për të shkuar në stërvitje pavarësisht se çfarë ndodh, qoftë i vetëm apo i shoqëruar me ndokënd.

Motivet e brendshme janë stimujt që e bëjnë njeriun e zakonshëm të kryejë vepra që janë më të mëdha se sa shkalla e zakonshme (rëndomtë) dhe të arrijë rezultate të larta... Potencialet e fshehta të forcës, që gjenden brenda nesh qëndrojnë prapa suksesit të njeriut. Ato e vejnë në pah dallimin që ekziston ndërmjet njerëzve... Ato janë forca që të shtyjnë që ti vetë t'i mbjellësh lulet, në vend që të presësh që dikush tjetër t'i dhurojë ato... Motivet e brendshme janë dritë që buron prej nesh... Ato i ngjajnë një vullkani në thellësinë tonë, që në çdo moment pret të shpërthejë. ■

PËRPARA SE T'I DREJTOHESH KËRCËNIMIT

DR. MAHMUD SHUREJMI


Shumë baballarë dhe nëna përdorin metodën e kërcënimit me fëmijët e tyre, ose për t'i nxitur për të zbatuar një urdhër, ose për t'i ndaluar nga një veprim jo i pranueshëm. Kërcënimi nuk vlerësohet –në shumicën e rasteve- si një metodë edukuese e suksesshme, sepse ai nuk e nxit fëmijën për t'iu bindur urdhrave të prindërve në mënyrë të pranueshme dhe të kënaqshme për të, dhe kjo si rezultat i zbatimit të tyre në formë detyruese prej tyre. Madje kërcënimi nuk na ndihmon në thyerjen e kundërshtimit tek disa fëmijë që binden me vështirësi, apo kur shtysat e tyre psikologjike janë të atilla që e nxisin atë për të praktikuar sjellje, që e bëjnë të bjerë në sy dhe të tërheqin vëmendjen e të tjerëve, ku ndër to bën pjesë inati i mbështetur me kërcënime. Për këtë arsye nuk është e përshtatshme që prindërit –dhe edukuesit në përgjithësi- t'i drejtohen kërcënimit për çdo veprim të madh dhe të vogël. Ndonjëherë dëgjojmë disa prindër, që përsërisin kërcënime të tilla si: “Nëse të dëgjoj edhe një herë tjetër ta ngresh zërin do ta thyej kokën”, ose dëgjojmë nënën të përsërit fjalët: “Pasha Allahun! Nuk do të marr me vete tek lojërat, nëse nuk e ha ushqimin”, siç mund të dëgjojmë edhe disa prindër të tjerë, që kërkojnë prej një fëmije dy vjeçar që të mos e derdhë lëngun mbi rroba, kur ai pi nga një gotë e hapur, në rast se nuk i shkon për shtat

t'i thuhet: “Nëse e derdh lëngun edhe një herë tjetër nuk do të marr në lulishte.”

Gjërat përkeqësohen edhe më, atëherë kur kërcënimet shoqërohen me të bërtitura, me zë të lartë, ose me shikime që mund të jenë të frikshme. Fëmija i shikon të dy prindërit e vet, si burim dashurie, mirësie dhe butësie, dhe nëse prej gojës së tyre dalin shprehje të frikshme, fëmija do të shtanget nga ky ndryshim i shpejtë, gjë që e bën të humbë qëndrueshmërinë shpirtërore brenda shtëpisë së tij, një fenomen ky që mund të thellojë problemin e mosbindjes ndaj urdhrave. Situata mund të shkojë më tej –nëse kjo ndjesi e fëmijës forcohet - drejt problemeve më të mëdha.

Përdorimi i kërcënimit duhet të jetë një çështje e mirëplanifikuar më parë, në mënyrë që të japë frytet e veta pozitive për prindërit dhe fëmijën. Për këtë është e domosdoshme, që prindërit të luajnë rolin e tyre edukues fillimisht, përpara se të presin prej fëmijës së tyre që të ndjekë direktivat e dhëna, ose që të sillen në mënyrë të pëlqyeshme para të tjerëve. Që mundësitë e bashkëpunimit mes prindërve dhe fëmijës të shtohen duhet që prindërit të veprojnë si më poshtë:

- Mësimi i fëmijës fillimisht në një shkallë të mjaftueshme, duke u siguruar që ai ka kuptuar atë që ata dëshirojnë prej tij në mënyrë të qartë, sepse nuk është e logjikshme, që një baba të kërkojë prej një fëmije katërvjeçar që të mos t'i tregojë asnjë



**“Fëmija i shikon të dy
prindërit e vet, si burim
dashurie, mirësie dhe butësie,
dhe nëse prej gojës së tyre
dalin shprehje të frikshme,
fëmija do të shtanget ...”**

sekret të fëmijëve të tjerë. Fëmija është një qenie shoqërore dhe ai shpreh atë që i vjen nëndërmend me pafajësi të plotë. Për këtë arsye ai mundohet që të tërheqë vëmendjen e të tjerëve duke iu treguar atyre gjëra tërheqëse që i ka parë ose dëgjuar. Kjo mund të përbëjë një shkak për zemërimin e prindërve me të.

- Siguria nëse ai fëmijë ka mundësi të zbatojë atë sjellje në mënyrë të logjikshme, sepse çdo moshë shoqërohet me aftësi që përshtaten me nivelin e rritjes mendore, trupore, dinamike dhe disiplinore. Për këtë arsye nuk pritet që fëmija t'i bindet urdhrin të nënës për të mos marrë nga ëmbëlsira që i serviret nga shoqja e saj mikpritëse bashkë me kafënë.

- Dhënia e një mundësie për të korigjuar sjelljen e tij. Kur fëmija bën një gabim jo të qëllimshëm është me vend që prindërit t'i shpjegojnë atij se kjo sjellje është gabim. Kështu kur fëmija godet vëllanë e tij më të vogël, ne duhet të kërkojmë prej tij që t'i kërkojë falje, ta puthë dhe ta përqafojë të

vëllanë.

- Sigurimi për mosprezencën e nxitësve të fortë, të cilat e shtyjnë fëmijën drejt kësaj sjellje. Fëmijët zotërojnë energji të lartë, e cila duhet të shkarkohet në mënyrën e duhur, në të kundërt ajo mund të shkarkohet në mënyrë negative, si p.sh.: Provokimi i vëllait nga ana e fëmijës më të vogël gjatë zgjidhjes së detyrave shkollore, ku hutimi i fëmijës më të vogël me gjëra të vogla do të jepte garanci për zgjidhjen e problemit.

Shumë studime që merren me sjelljen e fëmijëve aludojnë se kërcënimet e shumta që i bëjnë prindërit fëmijës së tyre –ose

edukuesit në përgjithësi- e bëjnë atë më pak bashkëveprues me kalimin e kohës dhe ndoshta i forcojnë zemërimin përbrenda, ose i falin një krenari që e bën të kuptuarin me të më të vështirë, ashtu si dhe shumë kërcënime e bëjnë fëmijën të mos ndjejë siguri, se është i ekspozuar ndaj rrezikut të privimit, ose ndëshkimit, sa herë që bën diçka që nuk i pëlqen prindërve. Këto ndjesi bëjnë që në përfundim fëmija ta shohë veten me syrin negativ, që e privon nga ndjesia e të qenit i dashur nga prindërit e tij, ose nga ndjesia e të qenit një fëmijë natyral, si gjithë të tjerët, që e përjetojnë fëmijërinë e tyre në një mjedis plot familjaritet dhe dashuri.

Por mospraktikimi i kërcënimit nuk do të thotë t'i lëshosh frerët fëmijës. Është me rëndësi që fëmija të kuptojë se sjellja e gabuar është e refuzuar plotësisht. Kur fëmija e mëson këtë, ndoshta përpiqet që ta thyejë këtë rregull duke vënë në provë prindërit e tij dhe duke njohur kështu reagimin që do të shfaqin ata karshi thyerjes së urdhrave të tyre. Cila është zgjidhja në këtë rast?! A është më mirë t'i drejtohesh kërcënimit, apo të japësh ndëshkimin menjëherë?!


Zgjidhja shembullore në këtë rast nuk qëndron tek këto dy sjellje, edhe pse ato përbëjnë rastet më të përhapura tek baballarët dhe nënat, madje për mësimin e fëmijës padyshim duket të ketë pasoja për sjelljen e mirë dhe pasoja për sjelljen e keqe. Ekziston mundësia që fëmijës t'i thuhet jo në kohën e bërjes së gabimit, se agresiviteti me fjalë ose me trup kundër të tjerëve nuk është i pranueshëm. Kështu, ai që vepron në këtë mënyrë do t'i tërhiqet vërejtja herën e parë dhe nëse e përsërit për herë të dytë, do të kërkohet prej tij që të mbyllet në dhomën e tij për një gjysmë ore dhe pas kërkimit të faljes, ai mund të dalë prej andej. Nëse përsëritet për herë të tretë, ndëshkimi do të jetë privimi i tij nga shikimi i televizorit për

“Por mospraktikimi i kërcënimit nuk do të thotë t'i lëshosh frerët fëmijës. Është me rëndësi që fëmija të kuptojë se sjellja e gabuar është e refuzuar plotësisht...”

një ditë të plotë –për shembull- ose privimi i tij nga shoqëria e vëllezërve që do të shkojnë tek lojërat.

Gjithashtu është me rëndësi –që të përforcojmë sjelljen pozitive tek fëmija- që të zbatojmë atë që themi. Kur e paralajmërojmë fëmijën se ndëshkimi i kësaj veprë do të jetë kjo dhe kjo, fëmija duhet ta marrë ndëshkimin dhe ta përjetojë atë, në mënyrë që ai ndëshkim ta zmbarsë nga përsëritja e gabimit herë tjetër. Kështu, bëhet e ditur se çështja nuk është thjesht një e bërtitur, gjurma e së cilës fshihet me t'u qetësuar nervat dhe e harrojmë. Nuk duhet që të na vënë poshtë ndjenjat tona, duke e falur fëmijën kur ai kërkon falje, ose kur shohim lotët që rrjedhin në faqet e tij. Por në të njëjtën kohë ne nuk duhet t'i tregojmë fëmijës, se po e trajtojmë ndryshe nga vëllezërit e tij, por t'ia bëjmë të qartë se ai po ndëshkohet vetëm për shkak të sjelljes që e meriton të ndëshkohet. Është e dobishme që kur fëmija të qetësohet, duhet që njëri nga prindërit –preferohet ai që nuk ka dhënë ndëshkimin- t'ia bëjë të qartë fëmijës se sjellja e treguar prej tij është e papranueshme dhe se ai duhet të kërkojë falje për të para të gjithë atyre që u prekën prej saj. ■

Nga arabishtja: Genc Plumbi



SURETU NISA - PRIVILEGJ PËR FEMRËN

PËRGATITI: ENVER AZIZI

Allahu subhanehu ve teala nuk ka përmendur ndonjë sure enkas për burrat në Kuranin Famëlartë, ndërsa për gratë e ka bërë duke emërtuar një nga

suret më të mëdha të Kuranit Famëlartë. Kjo dëshmon se Islami i ka kushtuar kujdes të veçantë gruas, duke e nderuar me këtë sure. Kjo sure ngërthen në vetvete çështje, të cilat kanë të bëjnë me problemet e familjes, shtetit si dhe të shoqërisë. Shumica e ajeteve të kësaj sure

merret me çështjen e gruas dhe të drejtat e saj. Ai që mediton në këtë sure mund të kuptojë se gruaja ka një pozitë të lartë në këtë fe. Për këtë do të sjellim disa argumente që ta kuptojmë më lehtë këtë.

1. Allahu subhanehu ve tealë e ka krijuar gruan nga brinja e burrit dhe prej tyre janë zhvilluar shumë njerëz. Këtë na e vërteton ajeti kuranor ku Allahu subhanehu ue tealë, thotë: **“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra.”** (Nisaë 1). Sa herë që mbante ndonjë ligjëratë apo hutbe i Dërguari salallahu alejhi ue selem, e lexonte këtë ajet. Këtu nuk përjashtohen, as dijetarët, as ata që i këshillojnë njerëzit.

2. Ruajtja e të drejtave të jetimit.

Allahu subhanehu ue tealë në një ajet të kësaj sure thotë: **“Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri ose me katër. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.”** Nisaë 3

Pra, nëse doni të martoheni me ndonjë grua, e cila ka me vete bonjakë dhe keni frikë se nuk do të jeni të drejtë ndaj tyre, atëherë më mirë është që ta leni atë rast e të martoheni me ndonjë tjetër, e cila nuk ka bonjakë.

3. Allahu subhanehu ve tealë e ka lejuar martesën deri me katër gra, por nëse ne i frikësohemi padrejtësisë, atëherë duhet ta reduktojmë në një dhe këtë e vërteton ajeti kuranor ku u tha: **“E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre) atëherë vetëm me një...”**, që d.m.th.: Nëse frikoheni se nuk mundeni të jeni të drejtë ndërmjet tyre atëherë martohuni vetëm me një e kjo

“Besimtari nuk e urren besimtaren, e nëse e shqetëson ndonjë veti e saj, le të kujtojë vetitë e mira të saj dhe le të kënaqet”...”

është respekt ndaj gruas.

4. Femrës i takon trashëgimia nga prindërit ose nga të afërmit e saj. Tek arabët në kohën e injorancës gruaja nuk e ka pasur këtë të drejtë, por me ardhjen e Islamit e fitoi këtë të drejtë gjegjësisht me zbritjen e ajetit kuranor: **“Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).”** (Nisaë 7).

5. Diferenca në trashëgimi mes burrit dhe gruas.

Allahu subhanehu ue tealë në Kuranin Famëlartë thotë: **“Allahu urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra...”** (Nisaë 11). d.m.th. Allahu ju urdhëron që mashkullit t'i jepni hise sa dy femra. Urtësia në këtë ajet është se mashkulli jep mëher për t'u martuar dhe se ai duhet të kujdeset për furnizimin e familjes. Abdullah b. Abasi radijallahu anhumë thotë: Në fillim ishte që pasuria i takonte e gjitha djalit dhe babai ia lente me testament kujt të donte. Por kjo gjë u zhvleftësua me një rregull tjetër, që mashkulli të marrë sa dy femra, prindërit të marrin një të gjashtë dhe një të tretën, gruaja të marrë një të tetën dhe një të katërtën, e burri të marrë gjysmën dhe një

të katërtën. E shënon Buhariu.

6. Burri duhet që t'ia japë **mehrin** gruas sipas marrëveshjes

Allahu subhanehu ue tealat thotë: **“Grave jepuni dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) atë që është më e mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i tyre ju falin diçka nga ajo, atëherë hajeni atë hallall të mirë.”** (Nisaë 4). Ibën Abasi radijallahu anhu thotë: (dhurata e kurorës) këtu është për qëllim **mehri**, që duhet t'ia japë burri gruas. E nëse ajo ia fal, atëherë lejohet që ta shfrytëzojnë atë së bashku.

7. Burrat janë urdhëruar që të sillen mirë me gratë.

Këtë mund ta kuptojmë nga pjesa e ajetit të nëntëmbëdhjetë të kësaj sure, ku Allahu subhanehu ve tealat thotë: **“Dhe silluni mirë me to”**, d.m.th., flisni atyre fjalë të mira, silluni mirë me ta ashtu siç keni dëshirë që ato të sillen me ju. I Dërguari i Allahut subhanehu ve tealat thotë: **“Më i miri ndër ju është ai që sillet mirë me familjen e tij, kurse unë jam më i miri ndër ju në sjelljen ndaj familjes”**. E shënon Tirmidhiu, ndërsa Albani thotë se është sahih.

8. Burri edhe pse e urren ndonjëherë gruan, ai nuk duhet ta braktisë atë.

Këtë e dëshmon ajeti kuranor: **“Nëse i urreni ato, bëni durim pse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni.”** (Nisaë 19). Ibën Abasi radijallahu anhu thotë: Nëse sillesh mirë me te dhe nuk e braktis, ajo do të bëjë fëmijë dhe do të kesh shumë të mira. Ndërsa Muhamedi salallahu alejhi ue selem, thotë: **“Besimtari nuk e urren besimtaren, e nëse e shqetëson ndonjë veti e saj, le të kujtojë vetitë e mira të saj dhe le të kënaqet”**.

9. Nuk lejohet që burri të merr diçka nga mehri i të shkurorëzuarës.

Allahu subhanehu ve tealat thotë: **“Në**

qoftë se dëshironi të ndërroni një grua në vend të një gruaje (të lëshuar), **e asaj** (të lëshuarës) **i keni pas dhënë një shumë të madhe, mos merrni prej saj asnjë send. A doni ta merrni atë pa të drejtë e në mënyrë mizore?”** (Nisaë 20). d.m.th., nëse dikush e ka shkurorëzuar gruan e tij dhe kurorëzon ndonjë grua tjetër dhe gruas së parë ia ka dhënë tashmë mehri, ai nuk ka të drejtë t'i marrë diçka nga mehri i saj, le të jetë ajo shumë e vogël apo e madhe. Muhamedi salallahu alejhi ue selem, në Hutben e Lamtumirës ka thënë: **“Ju këshilloj që të silleni mirë me gratë e juaja, sepse ata i keni marr me besën e Zotit dhe me fjalën e Zotit iu janë bërë hallall juve”**.

10. Prej nderit të gruas është se ajo e ka të ndaluar që të martohet me të afërmin nga gjaku dhe nga qumështi.

Allahu subhanehu ue tealat thotë: **“U janë ndaluar juve: nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezëtuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gj, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjehtat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura** (prej tjetër babai), **nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt, e nëse nuk keni pasur kontakt me to** (me gratë), **atëherë s'ka pengesë** (të martoheni me ato vajza), **dhe** (janë të ndaluara) **gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj** (jo të bijve të adoptuar), **dhe të bashkoni** (njëherësh në një niqah) **dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet Allahu fal shumë, është mëshirues i madh.”** (Nisaë 23). Kjo ndalesë është bërë që të mos përzihet gjeneza e njerëzve, ndërsa ndalesa për bashkimin e dy motrave në një kurorë është që mos të mbillet armiqësi ndërmjet motrave. ■

NËNA DHE BASHKËSHORTJA, SI DY ANË TË PESHORES KU I BËHET DËM NJËRËS PËR LLOGARI TË TJETRËS

HUSEJN B. KASIM EL-KATISH

Allahun e lavdërojmë dhe e falënderojmë dhe lutemi që pagja e bekimi të jetë mbi të Dërguarin e Allahut.

Nëna dhe bashkëshortja janë si dy krahët e peshores, por njërës prej tyre i bëhet zullum për llogari të tjetrës. Sa prej nënave të dashura janë nëpërkëmbur, janë fyer, janë nënçmuar, janë rrahur, madje janë vrarë, bile janë dërguar edhe në shtëpinë e pleqve?! Nga kush?! Nga i biri i saj, nga pjesa e mushkërive të saj, nga dashuria e saj, nga pjesa e shpirtit të saj, nga djali i saj pra!!

Pse e gjithë kjo nëpërkëmbje? Pse e gjithë kjo vrazhdësi dhe ashpërsi ndaj nënës së dashur, ndaj nënës së butë, ndaj nënës së mëshirshme, ndaj nënës së shtrenjtë, ndaj nënës, e cila asnjëherë nuk ka fjetur para se të flejë i biri, asnjëherë nuk ka pushuar para se ai të pushojë, asnjëherë nuk hëngri para se ai të ngopet, asnjëherë nuk piu para se ai të flladitet, ndaj nënës e cila asnjëherë nuk qetësohet dhe rehatohet përderisa të marri vesh se pjesa e mushkërisë së saj është rehat dhe në lumturi? Pse pra, të ndodhë kjo

“...Ngurtësia, vrazhdësia dhe gjërat e rënda që përjetojnë nënat janë të papara dhe të pabesueshme...”

ngurtësi ndaj nënës? Apo që gruaja e tij të jetë e kënaqur? Apo që gruaja të jetë rehat? Apo që të arrihet kënaqja e këtij apo e asaj? Apo që të jetë e lumtur bashkëshortja?

Me të vërtet fatkeqësi dhe trishtim, nga keqardhja zemra dërmohet, nga frika e urrejtja shpirti shkrihet dhe nga ligësitë që shohim e dëgjojmë, syri loton gjak.

Ngurtësia, vrazhdësia dhe gjërat e rënda që përjetojnë nënat janë të papara dhe të pabesueshme. Kam dëgjuar edhe asi rastesh që dikush së bashku me të shoqen janë bërë bashkë për ta vrarë nënën, ndërsa tjetri për ta rrahur. Shumë të tjerë i nënçmojnë dhe i fyejnë nënat, të tretët i vendosin nëpër shtëpitë e pleqve, të katërtit i bojkotojnë dhe nuk i vizitojnë asnjëherë, ndërsa të pestit i vlerësojnë bashkëshortet më shumë se nënat.

Bashkëshortes i jep, për të kujdeset, atë e thërret në telefon, atë e bekon, për të interesohet, asaj i jep dhurata, ndërsa për nënën as që pyet, as dhurata, as telefonata dhe as që i intereson shëndeti i saj. **“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”.**

Kjo është gjendja e shumë njerëzve. Ku janë ata që blejnë parfume, ar dhe rroba (të modës më të fundit), ndërsa nënave nuk u dhurojnë asgjë?! Ku janë ata, që i ndërrojnë shpesh orenditë e shtëpisë, por shtëpinë e nënës e harrojnë?! Ku janë ata, që bashkë me fëmijët e tyre jetojnë në luks, ndërsa nëna e tij jeton si është më zi?! Si do të jetë gjendja e tyre para Allahut?! Këta, sikur të mos kenë në zemrat e tyre pikën e mëshirës, si do t'i përgjigjen Allahut në Ditën e Kiametit, kur do t'i pyesë për nënat e tyre? Me çfarë fytyre do të dalin para Allahut?!

Vëlla i nderuar, nuk po them ta lësh bashkëshorten pa gjë, as që t'i bësh zullum që nëna jote të kënaqet, as ta nënçmosh dhe ta fyesh me të padrejtë, që ta kënaqësh nënën tënde. Kjo nuk lejohet, sepse ato i keni marrë në besë të Allahut dhe nderin e tyre e keni bërë për vete në emër të Allahut. Bëji mirë asaj dhe jepi atë që e ke detyrim, madje edhe më shumë, varësisht nga mundësia jote. Kështu kërkon Feja nga ti. Madje nga trimëria dhe burrëria e mashkullit është që t'i japësh bashkëshortes dhe ta nderojë. Siç është thënë: “Ato i nderon vetëm bujari, ndërsa i nëpërkëmb vetëm i poshtri”.

Mirëpo, o vëlla i nderuar, mos e bëj këtë në llogari të nënës tënde, sepse ajo është e dashura më e shtrenjtë te ti, pas dashurisë së Allahut dhe Resulullahut, salallahu alejhi ue selem. Ajo e meriton më shumë bamirësinë tënde, dhuratat, kujdesin dhe lodhjen tënde. Ajo ishte që të mbajti në barkun e saj, ajo ishte që të mëndi nga gjiri i saj dhe ajo ishte që të rriti, u lodh dhe shumë net mbeti pa gjumë për ty. Prandaj më të shtrenjtë se ajo nuk ka,

as shoqja, as fëmija, sepse ajo me babanë tënd janë shkak – pas Allahut – për ekzistencën tënde në këtë dynja.

Vëlla i nderuar, drejtësia dhe plotësimi i haqeve ndaj secilit janë të zorshme për shumë njerëz, sepse nuk mundën të vlerësojnë hakun e secilit, nuk mundën të kujdesen për të gjithë që t'i plotësojë haqet dhe të kryejnë detyrimet ndaj tyre. Ky është një realitet që sot shihet dhe përjetohet, prandaj takon të atillë që tregojnë respekt ndaj nënës, kujdesen për të dhe e vizitojnë, por në anën tjetër i bëjnë zullum bashkëshorteve, nuk i nderojnë dhe nuk interesohen për to, gjë e cila është gabim. Sepse zullumi nuk lejohet. Ai e ka për detyrë që nënën ta respektojë, ta vizitojë dhe t'i bëjë mirë, e po ashtu edhe bashkëshorten ta nderojë dhe të tregojë kujdes për të.

Në anën tjetër ka syresh që kujdesen për bashkëshorten, e nderojnë, rrinë me të dhe ndaj saj shprehin kujdesin më të madh, ndërsa nënën e braktisin, nuk e vizitojnë dhe nuk interesohen për të. Zullumi i këtij është edhe më i rëndë sesa i të parit. Sepse zullumi dhe padrejtësia ndaj nënës nuk është njësoj me atë ndaj bashkëshortes, edhe pse ndaj të dyjave është e ndaluar.

Jemi të detyruar të mbajmë baraspeshën dhe të jemi bamirës ndaj nënës e po ashtu ndaj bashkëshortes.

Vetëm pak e kanë shkathtësinë që të mbajnë baraspeshën e këtyre dy anëve, madje shumë pak janë ata.

Allahun e lus që çdo djalë të jetë bamirës ndaj nënës dhe bamirës ndaj bashkëshortes. Gjithashtu e lus Allahun e Lartësuar që kreyt rininë ta udhëzojë nga rruga e mirë, e udhëzimit dhe e përmirësimit. Ndërsa paqja e mëshira qofshin mbi të dërguarin Muhamed, mbi familjen e tij dhe gjithë shokët e tij. ■

Vetëm Allahu jep suksesin.

Nga arabishtja: Omer B.

KËRKIMI I UDHËZIMIT ME KURAN

Me Kuran, armiqësia ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kthehet në dashuri ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

OMER EL ESHKAR

Kurani është prej atyre gjërave që sjell lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër dhe i udhëzon mendjet drejt imanit dhe dashurisë ndaj Allahut e të Dërguarit të Tij, me të meditohet, studiohen argumentet e sheriatit dhe të shkencës, ai rrëfen ngjarjet e pejgamberëve dhe besimtarëve të hershëm.

Ngjarja e Omer b. Vehabit me Safuan b. Umejen.

Muslimanët në betejën e Bedrit arritën një fitore të madhe, që Allahu e quajti Furkan – një fitore që e ndau të vërtetën prej të kotës, i ngriti myslimanët dhe i përuli jobesimtarët, u vranë 70 prej tyre dhe u zunë robër 70 të tjerë, ndërsa ata që mbetën gjallë në zemrat e tyre mbizotëroi dëshpërimi dhe dhimbja.

Historia përmend ngjarjen e dy kurejshitëve që ishin duke biseduar për betejën e Bedrit ku u vranë një numër i madh prej tyre dhe u zunë shumë robër. Omeri i tha Safuanit se mos të ishte borxhi ndaj të tjerëve dhe frika ndaj fëmijëve se do të humbin do të kisha shkuar në Medinë për ta vranë Muhamedin, ndërsa Safuani i cili ishte i pasur ia ktheu atij, se borxhin po e marr përsipër unë, ndërsa fëmijët e tu po i afrojmë tek fëmijët e mi. Omeri e mori shpatën

dhe u nis për në Medinë, ndërkohë që djali i tij ishte në mesin e robërve që u zunë në betejën e Bedrit. Posa arriti në Medinë atë e pa Omer b. Hatabi dhe tha: Pasha Allahun ky ka ardhur për të bërë ndonjë të keqe, pastaj iu tha sahabëve kapeni që mos ta dëmtojë Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. E çuan tek i Dërguari i Allahut dhe ai kur e pa i tha: O Omer, çfarë të sollti këtu? Ai i tha: Kam ardhur për njeriun, i cili gjendet tek ju, dhe e kishte fjalën për fëmijën e tij. I Dërguari e pyeti se: A ke ardhur vetëm për këtë gjë? Ai iu përgjigj po. Pejgamberi i tha: A nuk ishe ti dhe Safuani duke biseduar e i the këtë e këtë, ai të tha ty këtë e këtë dhe ti e more shpatën dhe erdhe tek unë? Ai i tha: Pasha Allahun, nuk ishte me ne askush tjetër që ta dëgjonte bisedën tonë, pastaj dëshmoi shehadetin, se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe se ti je i Dërguar i Tij. Ai besoi dhe hyri imani në zemrën e tij. I Dërguari i Allahut i tha shokëve të vet silluni mirë me vëllanë tuaj, mësojani Kuranin dhe lirojani robin- djalin e tij. Omeri u kthye në Mekë duke e bartur Islamin dhe imanin në zemrën e tij dhe e shfaqti më pas haptas Islamin.

Omeri b. Uehabi shkoi për ta vranë të Dërguarin e Allahut dhe shohim se si Pejgamberi i reziston me një qëndrim që Omeri nuk gjen rrugëzgjdhje tjetër përpos të thotë: La ilahe ilAllah, Muhamedun Resulullah. Nga i erdhi kjo të Dërguarit?

Kush e lajmëroi? Kush e mësoi? Nuk ka tjetër pos njërit e Ai është Allahu, që ia tregoi ngjarjen hollësisht.

Ngjarja e magjistarëve të Faraonit.

Nga kjo ngjarje kuptojmë qëndrimin e magjistarëve, të cilët i besuan Musait në sheshin e madh, ku ishin të pranishëm një numër i madh njerëzish, që ta shohin se çfarë do të ndodhë ndërmjet Musait që erdhi me argumente hyjnore dhe magjistarëve të faraonit. Erdhën magjistarët tek faraoni dhe i thanë: **“...A do të ketë shpërblim për ne nëse dalim ngadhënjimtarë? Ai tha: po, madje ju do të jeni atëherë prej më të afërmve! Musai u tha atyre: hidhni atë që keni për ta hedhur. E ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre duke thënë: për hir të madhërisë së faraonit, ne me siguri do të jemi ngadhënjyes! Atëherë edhe Musai hodhi shkopin e vet, i cili gëlltiste menjëherë gjithçka kishin improvizuar ata.”** Shura 41-45

Në çast ndryshon njeriu! Ishte rob i tagutit që mburrej me atë dhe kërkonte prej tij shpërblim, se njerëzit po shikonin në shesh se kush do të fitojë: Musai apo

Faraoni? Fitoi Musai me ndihmën e Allahut dhe magjistarët ranë në sexhde e thanë besuan në Zotin e botëve. Ajo që solli Musai nuk ishte magji, dhe ata u bindën për këtë, dhe kur e panë mrekullinë e kuptuan se kjo është vetëm prej Allahut, Krijuesit të gjithësisë, gjë të cilën nuk ka mundësi ta veprojë askush siç e vepron Ai, dhe e ndjenë imanin e bindjen në zemrat e tyre.

Thirrja për meditimin e ajeteve kuranore

Gjatë mbajtjes të një seminari në Egjipt e pranuan Islamin dy shkencëtarë, jo për gjë tjetër, por vetëm për atë që shkenca e zbuloi saktësisht dhe u vërtetua se Kurani Fisnik e ka përmendur këtë gjë para 14 shekujsh. Allahu në Kuran flet për etapat e zhvillimit embrional të fëmijës në mënyrë të detajuar dhe i përshkruan ato para se ta zbulojë dhe ta vërtetojë shkenca bashkëkohore. Këta dy shkencëtarë ishin specializuar në këtë fushë dhe u mahnitën me këtë fakt kuranor. Allahu i Madhëruar thotë: **“Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër. I Lartë është Allahu, më i miri**



Krijues!” Muminun -14

Ky dhe shumë fakte të tjera në gjithësi duhet ta nxisin njeriun të meditojë rreth shpalljes së Allahut, mjeshtërisë madhështore në krijimin e Tij, si Komanduesi Suprem dhe i Vetëm, Ai që kontrollon dhe i ndryshon gjendjet si të dojë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu është Ai i vërteti dhe se Ai i ringjall të vdekurit dhe Ai ka fuqi për çdo send. Nuk ka dyshim që kijameti do të vijë patjetër dhe se Allahu me siguri do t’i ngjallë ata të varrezave.”** Haxh 6-7

Dihet rasti i Omerit radiaAllahu anhu, kur në një natë të errët ishte duke kaluar rrugës dhe dëgjoi njërin duke lexuar Kuran, ai u ndal të dëgjojë dhe kur arriti tek ajeti: **“Është e vërtetë se dënimi i Zotit tënd patjetër do të ndodhë. Atë nuk ka kush që mund ta largojë”.** (Tur 7-8) dhe nga meditimi i këtij ajeti që ndikoi fort në zemrën e tij ai u sëmur për një muaj rresht.

Por jo çdo herë dhe jo e njëjta ngjarje ndikon te çdo person. Një person, i cili ishte njeri arrogant tregon për shkakun e udhëzimit të tij dhe thotë: E kam ndjekur me vëmendje fëmijën e porsalindur, se si e thithte gjirin e nënës së tij dhe menjëherë fillova të mendoj për atë se kush e mësoi atë dhe kush e udhëzoi!

Allahu i Madhëruar thotë: **“Zoti ynë është Ai që i dha çdo sendi formën e vet, pastaj e udhëzoi atë.”** Taha 50

I sheh zemrat e njerëzve të mbështjella nga pakujdesia dhe ndodh një ngjarje në jetën e tij që të ndalet e të meditojë. Ai deri tani, as nuk është falur, as nuk ka lexuar Kuran kur papritmas e sheh ne xhami dhe kur e pyet se çfarë e shtyri për këtë gjë, ai të përgjigjet se me ka vdekur më i dashuri i familjes, apo shoku im më i ngushtë, dhe kur e përcollëm xhenazen e tij, e varrosëm e mbuluam me dhe’, fillova të mendoj se kush

“...ne kemi një nevojë të madhe për qetësimin e shpirtit, gjë të cilën e gjejmë vetëm në besimin e plotë tek Allahu, që i parandalon dhe i shëron të gjitha këto sëmundje që u përmendën ..”

do ta shoqëroj pasi e lamë vetëm, dhe thashë me vete se herët a vonë do t’i kthehemi Krijuesit tonë.

Metodat që ndikojnë në qetësimin e shpirtit

Në të kaluarën, por edhe sot sikurse më parë, në kohën kur shkenca dhe teknika ka arritur thuajse kulmin e gjejmë njeriun që ankohet përherë nga gjendja e rëndë e tij shpirtërore, shqetësimi, stresi, trauma për ata që nuk kanë Islamin si besim dhe zgjedhin si rrugëdalje të vetme për zgjidhjen e problemeve të jetës së tyre vetëvrasjen. Prandaj ne kemi një nevojë të madhe për qetësimin e shpirtit, gjë të cilën e gjejmë vetëm në besimin e plotë tek Allahu, që i parandalon dhe i shëron të gjitha këto sëmundje që u përmendën më lart. Allahu i Madhëruar thotë: **“Pastaj Allahu zbriti qetësinë e vet tek i dërguari i Tij dhe besimtarët.”** Teube 26 **“Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun zemrat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat qetësohen.”** Rrad 28. ■

Përshtati: Bashkim Bajrami

LUFTIMI I TË KËQIJAVE

Ebu Seid Hudriu, radijallahu anhu përcjell se e ka dëgjuar të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, duke thënë: *“Kush nga ju sheh një të keqe le ta ndryshojë (përmirësojë) atë me dorën e tij, nëse nuk mundet atëherë me gojë, e nëse edhe këtë nuk mund ta bëjë atëherë me zemrën e tij. E kjo gjendje është shkalla më e dobët e besimit”.*

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Këtë hadith me këtë tekst e shënon imam Muslimi në koleksionin e tij të haditheve të sakta, i cili njihet ndryshe tek dijetarët, por edhe tek masa e gjerë me emrin “Sahihu i Muslimit”. Ai e përcjell këtë hadith nga Kajs b. Muslimi, ky nga Tarik b. Shihabi, e ky nga Ebu Seid Hudriu. Po ashtu këtë hadith e sjell edhe me zinxhir të dytë transmetuesish, gjë të cilën imam Muslimi e bën që të ketë sa më shumë argumente për ta vërtetuar saktësinë e hadithit në fjalë. Senedi i dytë është përcjellë nga Muslimi, ky nga Ismail b. Rexhai, ky nga babai i tij, e ky i fundit nga Ebu Seidi. Muslimi me këta dy zinxhirë transmetuesish e përcjell hadithin fjalë për fjalë, hadith ky i cili përmban numrin rendor 49 në koleksionin e haditheve të tij.

Për sa i përket transmetimit të hadithit me kuptim, Muslimi e shënon edhe me zinxhirë të tjerë transmetuesish, si dhe nga sahabë të tjerë, siç është ai i Abdullah b. Mesudit, radijallah anhu, nr. 50.

Gjithashtu këtë hadith, pra, kuptimin e përafërt të tij e shënon edhe Bejhekiu në librin e tij, “Shuabul iman”, 6/95, nga Omer b. Hatabi, dhe në “Sunenin” e tij,

10/90 nga Aliu, Hakimi në “Mustedrek”, 4/512 nga Ebu Seidi, Ebu Amër ed-dani në “Es-sunen el varideh fil fiten” 1/222 nga Aliu, Taberaniu në “EL-Mu’xhem el kebir” dhe në “Evsat” nr. 6150, nga Ubade b.



“Këshillimi i shoqërisë dhe kundërshtimi i së keqes është detyrim individual për çdonjërin nga besimtarët...”

Samiti, Nuajm b. Hamadi në “El-fiten” 1/70, nga Aliu, Ibën Ebi Shejbeh në “Musanef”, 7/504, po ashtu nga Aliu, etj.

Të gjithë zinxhirët e këtyre haditheve, përveç atyre të imam Muslimit kanë kritika nga dijetarët e shkencave të hadithit, pra, i konsiderojnë disa prej këtyre zinxhirëve “të dobët” e disa të tjerë “të mirë”.

Rëndësia e hadithit.

Hadithi në fjalë është me të vërtet shumë i rëndësishëm, rëndësia e tij vërtetohet nga disa aspekte, ndër të cilat janë:

- Për shkak se është fjalë e të Dërguarit, salallahu alejhi ve selem, dhe udhëzim i tij, i cili nuk flet me hamendje, por çdo gjë që del nga goja e tij e ndershme është veçse shpallje nga Zoti.

- Është hadith i arritur tek ne me transmetues të denjë për të mbartur fenë dhe dispozitat e saj, e çdo gjë e mbartur me korrektësi gjeneratë pas gjenerate tregon se ka qenë vërtetë pjesë e Islamit, e cila mu për këtë shkak edhe nuk është zhdukur, sepse feja e Allahut nuk zhduket.

- Është mësim hyjnor dhe metodologji (mënyrë) konkrete për ta pasuar gjatë kundërshtimit dhe përmirësimit të të këqijave të paraqitura në shoqëri.

- Nuk ka mënyrë tjetër përmirësimi të suksesshme, të saktë dhe efikase përveç kësaj. Për këtë shkak dijetarët këtë hadith e quajnë ndryshe “**metodologjia e**

ndryshimit të së keqes”.

-Ajo është vetë tradita e Profetit, salallahu alejhi ue selem, i cili pati njëqind për qind sukses gjatë përmirësimit të shoqërisë që e rrethonte, e kjo ndodhi për hir të pasimit të këtij rregulli, pas ndihmës së Allahut.

Komentimi i hadithit:

- Fjala e Profetit, salallahu alejhi ue selem: “*Kush nga ju*”, me këtë fjalë ai na tregon se luftimin e së keqes e kemi detyrim secili prej nesh në veçanti. Pra, këshillimi i shoqërisë dhe kundërshtimi i së keqes është detyrim individual për çdonjërin nga besimtarët, të cilët e kanë kaluar moshën e pubertetit. Luftimi, përmirësimi apo vetëm pengimi i të këqijave nuk duhet të mendojë dikush se është detyrim vetëm i një pjese të caktuar të shoqërisë, qofshin ata hoxhallarët, njerëzit e xhamisë apo dikush i ngjashëm me ta. Askush të mos mendojë se nëse ata mundohen për mirë, të tjerët janë të shkarkuar nga kjo përgjegjësi. Kjo filozofi nuk qëndron dhe nuk është aspak e vërtetë, sepse fjala e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, e lartpërmendur e kundërshton atë, ngase ai nuk bëri kurrfarë dallimi me shprehjen e tij, por i përfshiu të gjithë në fjalën e vet, “*Kush nga ju*”. Pa marrë parasysh kush je; ti e ke përgjegjësi ta ndalosh apo përmirësosh të keqen, secili me aq sa ka mundësi dhe dituri, apo potenciale dhe kritere të tjera parimore; apo plotësuese që i nevojiten një përmirësuesi.

- “*sheh një të keqe*”. Kjo fjalë na mundëson të kuptojmë dy gjëra:

a. E keqja duhet të vërehet nga vetë personi që dëshiron përmirësimin e saj, apo nga ndonjë person i cili është besnik dhe i sinqertë në bartjen e lajmeve deri

tek ne se me të vërtetë ka parë ndonjë mëkat apo të keqe të caktuar duke u bërë. Ky person na bind plotësisht, se lajmi i tij është i vërtetë, aq i sigurt sikur të ishim vetë në vendin e ngjarjes.

Besimtari, si thirrës dhe përmirësues fetar e ka detyrim ta kundërshtojë vetëm atë të keqe që sheh apo dëgjon me veshët e tij dhe që bëhet haptas, apo nëse ka dëgjuar nga një njeri korrekt për lajme të tilla, të cilin e përmendëm pak më lart. Nuk është detyrim yni bile as nuk është e lejuar t'u futemi njerëzve nëpër shtëpi apo t'i gjurmojmë ata, si të ishim spiunë, duke i shikuar nga dritaret brenda shtëpive të tyre, apo mbi mure brenda oborreve të veta. Kjo vepër ndodh vetëm nga shpirtlligjtë dhe njerëzit e sëmurë mendërisht. Po, një gjë e tillë do të ishte e lejuar vetëm nëse do të ekzistonte shteti islam, i cili do të ngrinte aktpadinë kundër një të dyshuari për mëkate të caktuara dhe e urdhëron policinë fetare, që ta përcjellin të dyshuarin për t'u bindur, apo për të mbledhur argumente për akuzat që kanë ndaj tij. Kjo gjë në kohën tonë nuk ekziston, prandaj ne mbetemi vetëm si thirrës dhe përmirësues e jo polic apo gjykatës të njerëzve, që veprojnë mëkate kur janë vetëm, sepse këta njerëz i sheh dhe i dënon Ai, të cilit nuk mund t'i ikin askund kudo që janë.

b. Vepra të cilën dëshirojmë ndryshimin e saj në më të mirë të jetë me të vërtetë vepër e keqe, e gjykuar si e tillë nga Sheriati Islam e jo të jetë punë e turbullt për njerëzit apo të ketë rreth saj disa mendime të dijetarëve të Ehli Sunetit, ose të jetë e keqe për epshin e individit përmirësues, apo ai të mendojë se është e keqe duke mos pasur për të asnjë argument fetar që mbështetet në të.

- le ta ndryshojë (përmirësojë) atë me dorën e tij, kjo fjalë na jep të kuptojmë se

përmirësimi i të keqes është detyrim për besimtarët, sepse fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, është thënë në mënyrë urdhërore, fjalë e cila na sinjalizon detyrimin. Në hadith është përmendur ndryshimi apo përmirësimi, mirëpo kjo nuk nënkupton se njeriu nëse nuk arrin përmirësimin apo ndryshimin e së keqes, nuk e ka çuar urdhrin në vend, apo nuk e ka kryer detyrimin e tij. Përkundrazi hadithi ka si qëllim që besimtari të mundohet të bëjë diçka e të mos rrijë duarlidhur, duke menduar se nuk do të mund të bëjë asgjë, prandaj edhe nuk fillon fushatën e tij kundër të keqes. Pra, mjafton të ndër marrë ai diçka, aq sa ai ka mundësi në veten e tij, e nëse nuk arrin ta përmirësojë tërësisht mjafton, pjesërisht, nëse nuk mundet as pjesërisht mjafton që e ka penguar të keqen e nëse nuk mundet as ta pengojë, atëherë mjafton që ka përkrahur të mirën dhe ka qëndruar në një saf me vëllezërit e tij përmirësues.

Mënyra e parë, ajo më e shpejta, më efikase dhe më e suksesshme në shumicën e rasteve është ajo e përmirësimit me dorë. Mirëpo kjo duhet praktikuar vetëm me personat apo ndaj personave mbi të cilët besimtari ka pushtet, ose edhe vetëm autoritet, siç janë; fëmijët, familja, nxënësit etj. Kjo metodë zakonisht përdoret nga Shteti Islam për

“Kjo gjë në kohën tonë nuk ekziston, prandaj ne mbetemi vetëm si thirrës dhe përmirësues e jo polic apo gjykatës të njerëzve...”

“Kurrë nuk duhet të harrosh se me shprehje të mira shpeshherë ndryshon më shumë se me forcën e një ushtrie...”

përmirësimin e shoqërisë mbi të cilën ai sundon. Por kjo mënyrë duhet pasur kujdes të mos praktikohet mbi çdo njeri, e njëh apo jo natyrën e tij, apo mbi ata ndaj të cilëve nuk ke pushtet e ndodh më pas mos të jetë e suksesshme edhe me njerëzit që i ke nën pushtet, prandaj duhet pasur parasysh natyrshmëria e njeriut, që të arrish me të tek rezultati pozitiv sa më shpejt dhe sa më lehtë për të dy palët.

-nëse nuk mundet atëherë me gojë

Kjo mundësi e ndryshimit është ajo më e përhapura gjerësisht në botë, si dhe mund ta quajmë origjinë në këtë kapitull, dhe vlen për shumicën e vendeve, kohëve dhe njerëzve nëpër gjenerata. Përmirësimi me gojë zakonisht vlen nëpër vendet, të cilat nuk gjykojnë me shariat, por individët në mënyrë vullnetare mundohen për përmirësimin e shoqërisë.

Gjatë këtij misioni duhet pasur kujdes, që gjuha të jetë sa më e ëmbël, të ketë art të të shprehurit dhe të jesh i sjellshëm në gjuhë, sikurse me gjymtyrët e tua. Kurrë nuk duhet të harrosh se me shprehje të mira shpeshherë ndryshon më shumë se me forcën e një ushtrie, sepse fjala e ëmbël dhe qartësia në të shprehur është art, i cili nuk i jepet kujtdo.

-e nëse edhe këtë nuk mund ta bëjë atëherë me zemrën e tij:

Urrejtja e të këqijave me zemër është

detyrimi i fundit që duhet të ndërmarrë besimtari, nëse nuk ka mundësi të ndryshojë me dorë apo me gojë një situatë të pakalueshme. Urrejtja e së keqes me zemër është pjesa më e dobët e besimit, por kjo assesi nuk nënkupton mosangazhimin e saj kundër të keqes. Në situata të këqija kur besimtari nuk mund të ndryshojë haptas asgjë, atëherë për ta larguar përgjegjësinë nga vetja e tij e urren së paku me zemrën e vet, ngaqë mbi zemër nuk ka pushtet askush tjetër pos Allahut dhe bartësit të saj, vetë personit. Ndoshta me zemër nuk mund ta ndryshosh atë të keqe që është e pranishme në shoqëri, por mjafton që mos të jesh i kënaqur me të. Gjithashtu urrejtja me zemër bëhet shkak ta ruajë vetë personin të mos bjerë në atë gabim, e ka mundësi që një ditë të vijë koha që edhe ta përmirësojë atë me dorë apo me gojë. Gjithashtu urrejtja me zemër e largon nga përgjegjësia e gabimeve, që bëhen në praninë e besimtarit, edhe pse i sheh ai për hir të urrejtjes së tij me zemër, ngaqë ai aq ka mundësi të bëjë. E nëse punohet një e keqe dhe dikush dëgjon për të e kënaqet me atë gjë të keqe, e ka mëkatën njësoj sikur të ishte i pranishëm sipas hadithit të Profetit, salallahu alejhi ue selem, të cilin e ka shënuar Ebu Davudi, nr. 4345 me sened të mirë sipas Albanit.

-E kjo gjendje është shkalla më e dobët e besimit:

Urrejtja me zemër është shkalla më e ulët e besimit nën të cilën besimtari nuk duhet të bjerë kurrsesi. Gjithashtu nga kjo fjalë kuptojmë se besimi i myslimanit shtohet dhe pakësohet varësisht nga puna që punon dhe sa afër është ai ndaj Zotit të tij. ■

PREZANTIM I LIBRIT: INTEGRIMI I FESË DHE IDENTITETIT TE MUSLIMANËT E BALLKANIT


AUTOR: DR. MUSA MUSAI

Temat sikur feja dhe identiteti, duke filluar që nga viti 1990 e më pas, gjatë tërë periudhës së tranzicionit në shtetet ballkanike kanë qenë tema të rëndësishme, që e kanë ruajtur pandërprerë aktualitetin e tyre. Në veçanti mes grupeve muslimane që jetojnë në Ballkan, lidhja fe-identitet është përjetuar me një theks të veçantë dhe gjatë gjithë kohës feja është paraqitur si një mbi identitet i tyre. Nga vetë fakti që me përhapjen e Islamit, të cilin e kanë pranuar grupe të ndryshme etnike gjatë tërë kësaj kohe, identiteti fetar për shumë grupe etnike të Ballkanit ka luajtur rolin e një përfshirësi në një bashkësi.

Ky studim i realizuar në lëmin e psikologjisë së religjionit, hulumton dhe bën analizën e gjithëpërfshirjes së identitetit dhe fesë, ose të koncepteve identitet-fe mes muslimanëve që jetojnë në shtetet e Ballkanit, me theks të veçantë ata që jetojnë në Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë.

Qëllimet e këtij studimi janë: analiza dhe përshkrimi i perceptimeve dhe integritimeve në ndikimin e ndërsjellë të fesë-identitetit ndërmjet muslimanëve, të cilët jetojnë në shtete me sisteme politike të ndryshme, konstatimi i atij ndikimi për të cilin supozohet se ekziston mes identitetit-fesë.

Ngjarjet dhe fenomenet e përjetuara në njëerën prej qendrave më të vjetra të banuara të Evropës në Gadishullin Ballkanik, ashtu si në të kaluarën edhe tani janë duke e ruajtur



rëndësinë e tyre në nivele botërore. Rajonet e Ballkanit aq sa kanë qenë skena të rëndësishme për temat e filozofisë, kulturës dhe qytetërimit po aq të rëndësishme kanë qenë edhe për luftërat dhe konfliktet.

Së bashku me jehonën e shpartallimit të Bllokut Lindor pas viteve '90, fryma e këtyre ndryshimeve u ndje edhe në Gadishullin Ballkanik. Në veçanti me shpërbërjen e republikave të ish-Jugosllavisë filloi një periudhë e re historike në këto treva. Gjendja e shfaqur dhe luftërat e përjetuara pas viteve 1990 në këto vise, ishin paralajmëruesit e faktit që në mesin e popujve të Ballkanit nuk do të jetë e mundur që të përjetohet një periudhë e gjatë pa luftëra dhe konflikte.

Sot ndër shkaqet më të rëndësishme të gjendjeve të luftërave dhe konflikteve të përjetuara ndërmjet grupeve fetare dhe etnike të ndryshme, lidhen me ringjalljen e ndasive kombëtare dhe fetare të këtyre popujve. Me vetë faktin e peshës dhe vazhdimësisë së gjurmëve, të cilat i lënë fetë dhe identitetet fetare mbi identitetet individuale dhe shoqërore e veçanërisht kur ky identitet fetar unifikohet me identitetin etnik, ndonjëherë edhe shkas i dallueshmërive dhe që mund të

bëhet shkas i disa riformimeve dhe ndasive të ndryshme.

Duke pasur parasysh temat dhe ndodhitë socio-kulturore, që janë futur brenda kornizave të këtij punimi, problemin kryesorë të këtij hulumtimi mund ta parashtrijmë në formën e një pyetje në këtë mënyrë: **“si është gjendja sot e integritit të fesë-identitetit të Muslimanët e Ballkanit? Në këtë integritim, a ka marrëdhënie (relacione) mes faktorëve fetarë dhe atyre socio-kulturore (demografikë)?”** Duke pasur parasysh këto: cili është relacioni, apo si janë marrëdhëniet mes variacioneve të religjiozitetit me ngjarjet apo fenomenet për të cilat mendohet se mund të kenë ndikim në perceptimet e identitetit individual dhe social?

Qëllimi parësor i këtij punimi ka qenë, përcaktimi i integritit social tregues i të cilit është relacioni identitet-fe dhe nxjerrja në pah e kallëpeve në lidhje me reflektuesit e identitetit kulturor dhe fetar të muslimanëve të Ballkanit, të cilët jetojnë në ambiente të ndryshme socio-kulturore dhe gjeografike.

Si shtojcë e këtij qëllimi ka qenë edhe bërja e krahasimeve mes grupeve të ndryshme sipas variacioneve demografike (si fjala vjen gjinia, moshë, gjendja martesore, arsimit, të ardhurat, shteti, regjioni dhe të ngjashme më këto) me qëllim përcaktimin e faktorëve socio-kulturore nga të cilët lindin dallime në perceptimet e përbërësve të jetës fetare, siç janë “adhurimi dhe marrëdhëniet sociale”, “lidhshmëria ndaj kushteve të besimit fetarë”, “vetëdija e solidaritetit fetarë dhe social”, “respekti ndaj vlerave tradicionale dhe fetare” si dhe “perceptimi i ndjenjës sociale dhe fetare”. Brenda kornizës së problemit të shtruar të këtij studimi janë shqyrtuar edhe disa nën-probleme të tjera, që janë plotësim i problemit kryesor, edhe ato janë:

1-Në çfarë shkalle janë religjioziteti dhe qëndrimet fetare të grupit të anketuar të këtij studimi të përbërë nga muslimanët e Ballkanit?

2-Si e ka të formuar përbërjen e identitetit social dhe fetar i njëjti grup?

3-A ka dallime dhe ngjashmëri në strukturën e gjendjes së religjiozitetit dhe identitetit të muslimanëve të Ballkanit nga aspekti i faktorëve si shteti, moshë, gjinia, regjioni, arsimit dhe gjendja socio-ekonomike?

4-A ka ndonjë ndikim apo rol feja në jetët sociale të tyre? Nëse ka në çfarë drejtimesh është e orientuar? Dhe cilët janë ato dallime mes tyre në aspektin e perceptimeve të jetës fetare dhe identitetit social?

Studimet e bëra deri tani mbi lidhjet mes identitetit dhe fesë, tregojnë se shumë ndikim të thellë dhe përcaktues kanë besimet dhe qëndrimet fetare në lidhjet e individit me njerëz të tjerë, në veprimet morale, botëkuptimet mbi botën, si dhe mbi ndjenjat dhe mendimet e individit në tërësi. Nëse do të merrnim një shembull në ndërtimin dhe formimin e karakterit të një individi, i cili përfaqëson personalitetin e formuar më pas, ose më mirë thënë veçoritë shoqëro-kulturore, të cilat vijnë prej rrethit të personi, nuk është e mundur në tërë këto procese të mos e pranojmë rolin dhe ndikimin, që ka feja në këto lidhje.

Në këtë studim fetaria paraqet lidhshmërinë, në lidhje me kushtet e besimit fetar islam dhe adhurimeve, si dhe lidhshmërinë ndaj traditës, dokeve, dhe zakoneve, të cilat janë të shtrira dhe kanë ndikimin e vet në sistemin e vlerave morale dhe fetare, që janë brenda kulturës së shoqërive muslimane të këtyre trevave. Ngase veprimet dhe qëndrimet, mendimet dhe ndjenjat, vlerat dhe besimi i përbashkët, të cilët drejtojnë dhe i japin kuptim jetës së individit dhe të shoqërisë, atëherë këto janë faktorë që themelojnë lidhjen dhe sigurojnë vijimësinë mes së kaluarës, së sotmes dhe së ardhmes së një shoqërie apo të një populli. Brenda kësaj trashëgimie kulturore në sajë të gjuhës, traditës dhe dokeve jetohet dhe përjetohet feja. ■

BOTA ISLAME

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Që në fillimet e Islamit para më se 1400 viteve, mësimet e tij u bënë frymëzim për pasuesit, si për bashkëpunim, afërsi dhe njohjen e njëri-tjetrit dhe kjo u mishërua që me formimin e shtetit të parë Islam në Medinë.

Mu për këtë flasin edhe ajetet dhe hadithet e shumta të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Allahu thotë në Kur'an: "**Vërtet besimtarët janë vëllezër**". Huxhurat: 10. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thoshte: "*Besimtari është vëlla i besimtarit*". Muslimi.

Këto pikëpamje islame me të cilat myslimanët konsiderohen vëllezër, si dhe ndjenja që ngjall Islami në shpirtin e secilit prej pjesëtarëve të tij e bëjnë myslimanin që ta ndjeje veten të detyruar të jetë sa më afër vëllezërve të tij myslimanë, duke i njohur ata dhe duke kuptuar më mirë gjendjen e tyre e kjo është edhe prej motiveve kryesore që do të hapet kjo rubrikë.

Por kur flasim për Botën Islame nuk duhet të harrojmë edhe ndikimin e saj të madh historik, shoqëror dhe politik në të kaluarën dhe në të tashmen. Në një të kaluar jo të largët Bota Islame ishte ajo, që e udhëhiqte botën dhe ishte boshti kryesor i civilizimit dhe i kulturës. Shembujt që dha kjo botë në sfera të ndryshme, qofshin ato shoqërore, ekonomike apo politike, lanë mbresa në historinë e njerëzimit dhe e bënë atë periudhë një ndër faqet më të ndritura të saj.

Padyshim se frymëzim për tërë këtë ishte Islami - feja e vetme e vërtetë dhe e pëlqyer nga Allahu, e cila me mësimet e saj shndriti botën dhe ende e ndrit, duke i dhënë shpresë

për një jetë më të mirë. Duke vendosur të drejtat e njeriut, tolerancën dhe bashkëpunimin mes njerëzve dhe duke hedhur parimet e shëndosha të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Këto dhe të tjera ishin ato që e karakterizuan Botën Islame në të kaluarën në një masë të madhe dhe shpresojmë ta karakterizojnë atë edhe në të ardhmen, që ta marrë rolin e saj të merituar dhe të jete mirësi për tërë njerëzimin.

Si dhe me realitetin e krijuar në Kosovë - shpalljen e pavarësisë së saj të shumëpritur me 17/2/2007 dhe me rolin e pritur të shteteve muslimane në mbylljen e procesit të njohjeve dhe forcimin e pozitës së shtetit të ri të Kosovës ndihemi të detyruar të paraqesim para lexuesit tonë rubrikën Bota Islame, duke shpresuar që ta afrojmë atë te këto vende. Të shpalosim para myslimanëve forcën, potencialin dhe mundësitë, qoftë edhe shkurtimisht, që me anë të kësaj të largojmë sadopak nga vetja kompleksin e inferioritetit. Duke theksuar që në të njëjtën kohë informimi i këtyre shteteve me realitetin kosovar (në të gjitha sferat) është më se i rëndësishëm dhe shpresojmë që kjo të bëhet nga studentët fillimisht e pastaj të përmbillet me angazhimin e diplomacisë, e cila do të kishte rolin vendimtar në këtë proces.

Bota Islame sot është e ndarë në shtete të shumta, të cilat janë me shumicë myslimane apo myslimanët janë faktorë të rëndësishëm në to. Gjithashtu kësaj i duhet bashkangjitur fakti, se në shumë shtete islame pakicat luajnë një rol të rëndësishëm dhe janë faktor i rëndësishëm në ato shoqëri. Por ne do t'i afrojmë lexuesit dy nga organizatat më të mëdha përbrenda Botes Islame, të cilat luajnë

një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare dhe shpresojmë të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në rastin e çështjes shqiptare në tërësi dhe të Kosovës në veçanti, e këto janë:

Organizata e Konferencës Islamike:



Konferenca Islamike është organizata e dytë qeveritare për nga madhësia pas Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Anëtarësinë e saj e përbëjnë 57 shtete anëtare dhe që shtrihen në 4 kontinente. Konferenca Islamike konsiderohet zëri i përbashkët i Botës Islame. Kjo konferencë përpiket të ruajë interesat e Botës Islame dhe të shprehet për të, në përf forcimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet popujve të botës. Konferenca është themeluar në takimin historik të mbajtur në Rabat, kryeqytetin e Marokut, me 25 Shtator të vitit 1969 si kundërpërgjigje ndaj krimit të djegies së xhamisë el-Aksa në Kuds (Jerusalem) e pushtuar.¹

Kjo organizatë ngërthen në vete shumë organe të rëndësishme dhe qendra studimore, të cilat kanë rolin e tyre edhe më të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Për këtë organizatë dhe organet vartëse të saj hëpërhë nuk mund të zgjerohemi më shumë, por lexuesi mundet që për këtë të shfletojë ueb faqen e Konferencës në internet.

¹ Parathënie marrë nga faqja zyrtare e Konferencës Islamike: www.oic-oci.org

² Shkëputur nga buletini i Ligës Arabe në adresën e saj në internet: www.arableagueonline.org

Liga e Shteteve Arabe:



Kjo Organizatë është me karakter nacional dhe ngërthen në vete 22 shtete arabe dhe është themeluar më 22/3/1945. Kjo ligë erdhi si kërkesë e promovimit të vlerave arabe dhe për të treguar qëndrimin e popullit arab në çështjet e tij të përbashkëta. Ndër qëllimet e saj kryesore duhet veçuar:

Arritja e pavarësisë nga të gjitha shtetet arabe.

Ndërhyrja në rregullimin e mospajtimeve mes shteteve anëtare.

Inkurajimi i bashkëpunimit gjitharab, si në rrafshin politik ashtu edhe në sferat shoqërore dhe ekonomike.

Përfaqësimi i këtyre shteteve në organizatat ndërkombëtare.²

Këto dy organizata janë ndër organizatat më të rëndësishme, të cilat përfaqësojnë në masë të madhe Botën Islame, por shtetet e ndryshme islame janë anëtarë edhe të shumë organizatave të tjera ndërkombëtare, si OKB-ja, apo edhe shumë organizata me karakter ndërkontinental.

Pas kësaj paraqitjeje të shkurtër shpresojmë se lexuesi do ta mirëpresë këtë rubrikë dhe do të gjejë informacionet më të rëndësishme, të cilat do t'i mundësojnë njohjen e Botës Islame me të dhënat, që do të sillen në këtë rubrikë. Për çdo shtet do të paraqesim emrin zyrtar, kryeqytetin, vendndodhjen e tij, informata mbi popullatën, kur arriti Islami tek ata, si jetojnë, çfarë prodhojnë, ngjarjet më të rëndësishme historike, kur e arritën pavarësinë etj. ■

NDËRTIMI I XHAMIVE

Fetva nga dijetari i madh Abdullah Xhibrini

1 - Gardhi i xhamisë a konsiderohet pjesë përbërëse e xhamisë, dhe donatori që e ndihmon ndërtimin e gardhit: a e ka shpërblimin njësoj si ai që ndërton xhaminë?

Përgjigja:

Padyshim që xhamitë kanë nevojë për gardhe dhe mure, që duhet rrethuar nga të gjitha anët, pa këta gardhe xhamia mbetet e hapur dhe e pa mbrojtur nga kafshët zullumqare. Nga kjo nënkuptojmë se me ndërtimin e gardhit bëhet kompletimi i ndërtimit të xhamisë. Donatori që ndihmon ndërtimin e gardhit të xhamisë shpërblehet në bazë të asaj që ndërton, sepse ai me këtë përcakton kufijtë e xhamisë dhe mbyll oborrin. Dijetarët muslimanë kanë përmendur se oborri i xhamisë konsiderohet pjesë e xhamisë, kur është i rrethuar me gardh dhe se itakafi¹ është i lejuar në atë oborr. Në këtë oborr nuk lejohet që të hyjë xhunubi pa abdes, as gruaja që është me menstruacione deri sa të pastrohet. Transmetohet se edhe xhamia e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem ka

¹ Ibadet që manifestohet me qëndrimin e besimtarit në xhami për adhurim, gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit.



pasur oborr të rrethuar, siç përmendet në hadithin e bedunit që erdhi dhe bëri nevojën në skaj të xhamisë, e kjo na tregon se ai oborr ka qenë i rrethuar me gardh dhe se është e pamundshme të përcaktohet sasia e pronës së xhamisë pa i ndërtuar gardhin, i cili zakonisht është i lartë tre bërryl, që të mund të vendosen dyert për t'i hapur dhe mbyllur në raste nevojë.

2 - A konsiderohet vendbanimi i imamit dhe i myezinit, që janë brenda xhamisë, si pjesë përbërëse e xhamisë dhe donatori a shpërblehet sikurse ndërtuesi i xhamisë?

Përgjigja:

S'ka dyshim se xhamitë e kësaj kohe kanë më shumë nevojë për objekte shoqëruese (vakëfe), që të jenë pjesë përbërëse e xhamisë, sepse duhet caktuar imam dhe myezin i rregullt, që ta kryejnë punën si i ka hije. Nga shkaqet që ndihmojnë në kryerjen e punës së imamit me rregull është ndërtimi i një objekti me standarde të mira në afërsi të xhamisë. Po qe se vendbanimi i imamit është larg, atëherë imami e ka të vështirë të jetë i rregullt në xhami në të gjitha namazet. Në bazë të kësaj komisionet përgjegjëse për ndërtimin e xhamive kanë konstatuar se është e domosdoshme të ndërtohet vendbanimi i imamit dhe i myezinit në afërsi të xhamisë. Ndërtimi i këtyre vendbanimeve konsiderohet nga punët e mira për të cilën donatori meriton shpërblim të madh. Ky ndërtim mbetet vakëf për të gjithë besimtarët dhe shpërblimi është i vazhdueshëm edhe pas vdekjes së donatorit. Ai që ndërton kësi lloj objektësh, nëse nuk ka shpërblim njësoj me atë që ndërton xhaminë, atëherë ka shpërblimin e atij që ndihmon në kompletimin e ndërtimit të xhamisë.

3 - Nevojtoret a janë pjesë përbërëse e xhamisë dhe donatori a është i barabartë me

atë që investon në ndërtimin e xhamisë?

Përgjigja:

S'ka dyshim se nevojtoret janë nga gjërat e pashmangshme të xhamisë, sepse falësit kanë nevojë për t'u pastruar dhe për të mënjanuar papastërtinë. Çdokush që investon në ndërtimin e nevojtoreve dhe e sjell ujin brenda nevojtoreve meriton shpërblim të madh, i cili është i përafërt me atë që ndërton xhaminë, sepse ai është bërë shkaktar që falësit të jenë të pastër dhe ua heq falësve problemin e sigurimit të ujit.

4 - Nëse xhamia përfundohet dhe mbetet një sasi e caktuar nga buxheti i mbledhur për ndërtimin e xhamisë, a na lejohet që të hollat e mbetura t'i shfrytëzojmë në projekte të tjera bamirëse, apo duhet kërkuar patjetër leje nga donatori?

Përgjigja:

Është e pëlqyeshme në kësi lloj rastesh, kur teprojnë të hollat, që të njoftohet bamirësi pasi të përfundohet ndërtimi i xhamisë dhe të kërkohet leje prej tij, që të hollat të shfrytëzohen në ndërtimin e ndonjë xhamie tjetër. Por nëse siguroheni se donatori i ka dhënë të hollat duke i përgjithësuar në ndërtimin e xhamive dhe mos përcaktuar ndonjë xhami të posaçme, atëherë është e lejuar që të hollat të shpenzohen në ndërtimin e xhamive apo në plotësimin e tyre. Si për shembull një person i jep 100 mijë euro për ndërtimin e xhamive, është e lejuar që këto të holla të shpenzohen në ndërtimin e disa xhamive, ose në plotësimin e disa xhamive, që ju kanë mbetur gjëra që duhen plotësuar.

5 - Në rast se donatori i jep të hollat për t'u ndërtuar ndonjë xhami në një vend të caktuar dhe për shkaqe të caktuara bëhet a pamundshme ndërtimi i asaj xhamie, ç'duhet bërë në këtë rast dhe a duhet patjetër ta njoftojmë donatorin për ndryshimin?

Përgjigja:

Në këtë rast themi se njoftimi i donatorit për ndryshimin e bërë është i patjetërsueshëm dhe nëse kërkon që t'i kthehen të hollat duhen kthyer patjetër, por nëse ju autorizon që të ndërtoni një xhami tjetër në atë lagje apo në një lagje tjetër, atëherë ju lejohet që të veproni ashtu siç është më e arsyeshme. Edhe pse në të shumtën e rasteve qëllimi i bamirësit është që të ndërton xhami në ato vende ku nuk ka xhami, ose banorët e atij vendi janë të paafte për të ndërtuar xhaminë e lagjes së tyre dhe kanë nevojë për ndihmë.

6 - Pjesëmarrësi në ndërtimin e xhamisë a shpërblehet me një shtëpi në xhenet, sikurse shpërblehet ai që e ndërton plotësisht?

Përgjigja:

Po, shpërblehet me shpërblimin e lartpërmendur, me kusht që me të hollat e këtij bamirësi të jetë e mundshme të ndërtohet një pjesë e xhamisë dhe sasia e të hollave të mos jetë e vogël në krahasim me atë që kushton realizimi i projektit të ndërtimit të xhamisë. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush ndërton një xhami për hir të Allahut po edhe nëse është sa një fole zogjsh, Allahu ia ndërton një shtëpi në xhenet”*.

Çdo donacion me të cilin mund të ndërtohet xhamia plotësisht, ose një pjesë e xhamisë, si për shembull një të dhjetën ose një të pestën donatori shpërblehet në bazë të asaj që ka dhënë për atë xhami.

7 - Personi, i cili mbikëqyr ndërtimin xhamisë, ose merr pjesë në hapjen e puseve, duke mos u angazhuar fizikisht, por vetëm

me administrimin dhe udhëheqjen, a e ka shpërblimin njësoj si ai që ndërton xhaminë dhe a shpërblehet me një shtëpi në xhenet.

Përgjigja:

Shpresojmë që të ketë këtë shpërblim, sepse ky është bërë shkaktar që t'i sigurojë donatorët dhe që t'i nxisë ata të shpenzojnë në realizimin e këtyre projekteve madhështore. Gjithashtu ka shpërblimin e mbikëqyrjes, udhëheqjes dhe udhëzimeve, që i ka kryer gjatë realizimit të projektit. Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nxitësi për të mirë e ka shpërblimin njësoj me atë që bën të mirën, pa iu pakësuar aspak nga shpërblimi”*

8 - Sa është e lejuar që administratorët përgjegjës gjatë ndërtimit të xhamisë, të marrin për vete një sasi të caktuar nga buxheti i përcaktuar për ndërtimin e xhamisë, si kompensim për mundin dhe kohën që kanë harxhuar dhe a është e patjetërsueshme që të merret leje për këtë nga donatori?

Përgjigja:

Parapëlqehet që kërkesa të bëhet paraprakisht te donatori, që një sasi e të hollave të ndahet për interesat e mbikëqyrësve të xhamisë gjatë ndërtimit, ose t'u përcaktohet një rrogë mujore për t'ua kompensuar atë që po punojnë, ose mundin që po harxhojnë. Duhet të përpiqemi që të gjejmë vullnetarë, të cilët do të punonin pa pagesë, duke shpresuar shpërblimin tek Allahu subhanehu ue teala, por në të kundërtën donatori detyrohet që edhe administratorëve mbikëqyrës t'u përcaktojë rroga për mundin e tyre. ■

Përktheu: Muharrem Ismaili

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

BESIMTARET QË S'I HARROI HISTORIA

MUHAMED B. ABDULAZIZ

Falënderimi i plotë i takon Allahut. Lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.

Ka shumë raste nga historia, që ia vlen të merren për shembull nga femra muslimane në jetën e saj, si thirrëse në rrugë të Allahut. Bëhet fjalë për raste e situata nga ato gra muslimane emrat e të cilave i vulosi koha për të mbetur dëshmi e gjallë e ambicieve të larta.

Në jetën tonë kemi shumë nevojë për pishtarë të tillë, të cilat mu si yjet në qiell na udhëzojnë në rrugën e drejtë. Për këtë arsye po ju paraqes pjesë nga biografitë e këtyre grave në mënyrë që të përfitoni.

1. Hatixheja, bija e Huvejlidit:

Prej shembujve më të shkëlqyer për besimtaren, e cila dëshiron të jetë pishtar e rrugës së drejtë është shembulli i Hatixhes, bashkëshortes së Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem. Nga jetëshkrimi i saj po veçojmë rastin kur për herë të parë i erdhi shpallja Pejgamberit. Duhet të meditosh mirë, se si e qetësoi ajo Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, kur ai erdhi në shtëpi i trishtuar, me zemrën që i dridhej. Kështu duhet të jesh edhe ti me

bashkëshortin tënd, kur ai ballafaqohet me problemet e thirrjes islame. Burri ka nevojë të ketë përkrahjen e familjes së tij, në mënyrë që t'u bëjë ballë sfidave të ndryshme, që do ta provokojnë në misionin e tij. Po sjellim një tregim ashtu siç na e përcjell Ajsha radijallahu anha:

“(pasi i kishte ardhur Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, Xhibrili në shpellën Hira) ai u kthye në shtëpi tek Hatixheja, radijallahu anha, dhe zemra po i dridhej. Ai iu drejtua asaj: më mbuloni, më mbuloni! Ajo e mbuloi dhe pasi u qetësua i tha Hatixhes: Oj Hatixhe, më ka ndodhur një sprovë, më ka ndodhur një sprovë. Hatixheja i tha duke e qetësuar: “Mos u brengos se pasha Allahun, Allahu nuk të poshtëron ty. Ti je i drejtë kur flet, i mban lidhjet me farefisën, e ndihmon nevojtarin, e nderon mysafirin, u ndihmon njerëzve të marrin hakun e tyre.” E mori Hatixheja dhe së bashku shkuan te djali i axhës së saj Vereka b. Neufel, i cili kishte pranuar krishterimin dhe lexonte Inxhilin. Ai ishte i shtyrë në moshë dhe i verbër. Vereka e pyeti: Si është puna? Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, i tregoi se ç'kishte ngjarë në shpellën Hira. Vereka i tha: Ky që ke parë është Namusi, i cili i ka ardhur më parë Musait. Ah sikur t'isha i ri! Ah sikur t'isha gjallë kur do të të dëbojë populli yt!



Pejgamberi salallahu alejhi ue selem tha: A do të më dëbojnë?! Po, asnjëri s'ka ardhur më të njëjtin mision e të mos armiqësohet, i tha Vereka. Nëse jam gjallë deri atëherë e ke të tërë ndihmën time.”

Është shumë i çuditshëm qëndrimi i kësaj gruaje, si arriti ta qetësojë bashkëshortin e saj me një mençuri të rrallë, duke e përkujtuar Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, për mëshirën dhe drejtësinë e Allahut, për cilësitë e tij të mira, pastaj e çoi te Vereka, që ishte prift i krishterë dhe djali axhës së Hatixhes.

2. Ilja, e bija e Jakubit, bashkëshortja e Ejubit alejhi selam.

Motra ime! Ndërsa po lexon këtë fragment mendo pak rreth gjendjes së kësaj besimtareje, e cila tregoi një durim të madh me sëmundjen e burrit të saj, pasi kishin

qenë të pasur e me një jetë komode. Ajo nuk duroi një ditë, një muaj apo një vit, porse vite me radhë. Këto janë cilësitë e një gruaje, e cila u edukua në shtëpinë e pejgamberit. Ajo tregoi një durim që s'e duron shpirti dot, pos shpirtrave të mëdhenj.

Enes b. Maliku, radijallahu anhu, përcjell se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka rrëfyer: “Ejubin, pejgamberin e Allahut e kapi një sëmundje e rëndë për pesëmbëdhjetë vite rresht. Prej tij u distancuan të gjithë, të afërm dhe të largët pos dy vëllezërve më të ngushtë, të cilët e vizitonin në mëngjes e mbrëmje. Një ditë prej ditëve njëri prej këtyre të dyve i tha tjetrit: Pasha Allahun, Ejubi ka bërë ndonjë mëkat që askush tjetër nuk e ka bërë. Shoku i tij e pyeti: Po si kështu? Tjetri iu përgjigj:

Ka tetëmbëdhjetë vjet që Allahu nuk e mëshiron. Shoku i tij shkoi tek Ejubi, alejhi selam, i tregoi se ç'kishte thënë shoku tjetër e ai u brengos dhe e luti Allahun. Më pas doli për të kryer nevojën, kurse bashkëshortja e mbante për krahu. Ai u ndal për një çast kurse bashkëshortja u kthye. Allahu i shpalli Ejubit: **“Bjeri me këmbën tënde tokës! Ky është ujë i ftohtë, lahu dhe pi.”**

Ejubi, alejhi selam, i ra me këmbën e tij tokës dhe aty shpërtheu një burim. U la me ujë e atij burimi dhe u shërua. Kur bashkëshortja e tij u kthye sërish nuk e njohu prandaj e pyeti për Ejubin. Ai i tha: Unë jam ai. Ejubi, alejhi selam, kishte dy hambarë, njërin me grurë e tjetrin më thekër. Allahu dërgoi një re dhe mbi hambarin e grurit lëshoi ar derisa u mbush, kurse mbi hambarin e thekrit lëshoi argjend derisa u mbush.”

Vërtet ky është një shembull i rrallë i durimit të bashkëshortes së Ejubit dhe qëndrimit të saj me të për vite e vite me radhë, atëherë kur Ejubi, alejhi selam, kishte nevojë më shumë për të.

3. Umu Seleme, radjallahu anha:

Burri ka nevojë shumë për një grua të mençur, e cila do ta këshillonte dhe do ta ndihmonte në raste dhe rrethana të ndryshme. Këtë shembull e gjejmë në personalitetin e Umu Selemes, e cila tregoi një pjekuri të rrallë në një rast me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem.

“Ditën e Hudejbijes Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe shokët e tij kishin veshur ihramet për të kryer umren. Pasi përfundoi marrëveshja, besimtarët u detyruan të kthehen në Medinë pa e kryer Umren, sepse kjo kishte qenë njëra nga kërkesat e mushrikëve (jobesimtarëve) në këtë marrëveshje. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, u ngrit dhe i urdhëroi shokët e tij t'i thernin kurbanet dhe t'i rruanin kokat, mirëpo asnjëri prej tyre nuk

“...Ka shumë raste nga historia, që ia vlen të merren për shembull nga femra muslimane në jetën e saj, si thirrëse në rrugë të Allahut. Bëhet fjalë për raste e situata nga ato gra muslimane emrat e të cilave i vulosi koha për të mbetur dëshmi e gjallë e ambicieve të larta...”

e zbatoi urdhrin. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, i urdhëroi përsëri mirëpo ata të indinjuar nga kërkesat e mushrikëve e kishin të vështirë, që pa kryer umren të çliroheshin nga ihramet. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, hyri në tendën e Umu Selemes dhe i tha asaj: *Si është puna me këta njerëz?! Umu Seleme i tha: O i Dërguari i Allahut, ata janë të indinjuar nga ajo që ndodhi, ti mos i fol askujt, porse shko rruaje kokën dhe there kurbanin tënd. Kur ta bësh këtë njerëzit do të të pasojnë.* Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, doli nga tenda, veproi ashtu dhe të gjithë nxituan ta pasojnë atë.”

Sa këshillë e mirë ishte ajo e Umu Selemes që i dha Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Kjo na përkujton fjalën e urtë: “Nuk humb ai që këshillohet”. ■

Shqipëroi: Agim Bekiri